# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7741 E hënë 17 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinioni i Ditës

Nga AZGAN HAKLAJ



## Ushtria e Kosovës shteron ëndrrat serbiane

Edrejta e çdo populli për të pasur ushtrinë e tij dhe për t'u mbrojtur nga agresorët është e drejtë hyjnore dhe e panegociueshme e çdo populli. E kjo në rastin ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga VALBONA NATHANAILI



## Për një arsim universitar publik cilësor dhe falas

Mbas dhjetë ditësh, mbushur me protesta të studentëve të universiteteve publike në Rrugën e Durrësit, përballë Ministrisë së Arsimit, si dhe ...

Vijon në faqen 21



Studentët nuk tërhiqen, protestë edhe sot para Kryeministrisë

# "Çdo qytetar shqiptar, i lirë të bashkohet me ne. Na plotësoni kërkesat, ose grevë"

Rama, studentëve: Mos u bëni si Luli në çadër, nuk kërkoj pazar. Kryemadhi: Zgjoni ndërgjegjen kombëtare

VOLTIZA DURO

Studentët e universiteteve publike vazhdojnë të mos heqin dorë nga kauza e tyre, duke protestuar para Kryeministrisë deri në plotësimin e 8 kërkesave të tyre. Edhe dje, në ditën e 12 të protestës, të rinjtë me pankarta ...

Në faqet 2-3

## DREJTORI I ISSH: SOT NIS NDARJA E PARAVE, DATAT E TERHEQJES PER ÇDO TE MOSHUAR

# "GRAFIKU I PENSIONISTEVE PER TE MARRE SHPERBLIMIN"

Projektligji i plotë për pensionet, për ata që kanë kryer punë të rënda. Masa e përfitimit për çdo kategori dhe kriteret për të marrë paratë



*(Në foto)* Pensionistë (foto ilustruese)

Në faqet 6-7

VENDIMI I QEVERISE

## Pronarët, si do të ndahen 6 mln euro, lista e plotë me përfituesit

Në faqet 9-11

FITON OKETA E KOLA

## Emrat, kush janë antarët e rinj të Këshillit Kombëtar të PD

Në faqen 4

FALJA E FUNDVITIT

## 64 të dënuarit në Reç, letër ministres: Amnistoni të rinjtë dhe 60-vjeçarët

Në faqen 8

PROTESTA TEK "ASTIRI"

## Basha: Projekti i Unazës, korruptiv. Veliaj: Jetike, të gjithë do të kënaqen

Në faqen 5

PRESIDENTI META VLERESON ATDHETARET



## "Ideali kombëtar i skraparllinjve ka qenë përherë forcë në betejat për liri"

Në faqen 2

Dermatologia Megina Laçka: Si të kujdeseni për lëkurën gjatë dimrit

# Ylli Merja: Përdorni vajin e dafinës kundër gripit

*Mjeku popullor: Lufton edhe astmën, sinozitin dhe laringjitin*

Nga VOLTIZA DURO



Vaji esencial i dafinës është një ndër produktet më të përdorshme sidomos në periudhën e dimrit, pasi ndihmon në hapjen e rrugëve të frymëmarrjes tek fëmijët dhe të rriturit. Është shumë praktik për t'u përdorur dhe shumë efektiv. Ky vaj ndikon menjëherë në zhbllokimin e sinuseve. Dafina është ndër bimët më të përdorura që në lashtësi. Gjethet e dafinës përveç përdorimit si bimë medicinale, përdoren në gatime për aromatizimin e gjellës apo peshkut ...

Suplement

# PROTESTA E STUDENTËVE
## REAGIME

## Meta: Ideali kombëtar i skraparllinjve, forcë për liri

Presidenti Ilir Meta zhvilloi një vizitë në qytetin e Çorovodës, ku gjatë një ceremonie të veçantë të zhvilluar në Pallatin e Kulturës "Riza Cerova", vlerësoi Mustafa Kajo Bakiasin - Kapinovën (pas vdekjes) me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës", si edhe dekoroi me Titullin "Naim Frashëri" Baba Meleq Staravecka (pas vdekjes). Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Presidenti Meta vuri në dukje se skraparllinjtë kanë luftuar gjithmonë për liri, identitet dhe përparim shoqëror. "Ideali i tyre kombëtar ka qenë përherë forcë udhëheqëse në betejat e pafundme për liri dhe pavarësi. Skrapari ka qenë dhe është toka e burrave trima dhe e grave trimëresha, barrikadë e pakalueshme për çdo armik dhe bazë e palodhur e luftërave çlirimtare. Skraparllinjtë e kanë ditur vlerën lirisë dhe i kanë vlerësuar përherë energjitë e pafundme që çliron liria dhe dinjiteti. Nuk ka etapë dhe epope të luftës për pavarësi të Shqipërisë që bijtë e Skraparit të mos kenë pasur heronjtë dhe dëshmorët e vet!". Presidenti i Republikës vlerësoi Baba Meleq Staravecka dhe Mustafa Kajo Bakiasi (Kapinova),


Presidenti Ilir Meta dje në Skrapar

si dy figura të ndritura të Skraparit. "Nga ky panteon emrash të ndritur me propozimin e Komitetit të Veteranëve të Skraparit dhe të kryetarit të bashkisë, kam kënaqësinë të vlerësoj dy patriotë skraparllinj të shquar të lëvizjes sonë kombëtare dhe Pavarësisë së vendit: Baba Meleq Staravecka dhe Mustafa Kajo Bakiasi (Kapinova). Baba Meleq Staravecka, në traditën më të shkëlqyer atdhetare të bektashianëve tanë nuk e ndau kurrë fenë nga atdheu. Ai kontribuoi në mënyrë të jashtëzakonshme për edukimin e brezave më të rinj me dashurinë për atdheun, gjuhën shqipe dhe për Zotin. Mustafa Kapinova gjithmonë tregoi se kishte lindur për të luftuar vetëm për lirinë dhe progresin e popullit të tij. Mustafa Kapinova ka një kontribut të shquar në forcimin e shtetit të parë shqiptar, por edhe demokratizimin e shoqërisë shqiptare", tha Meta.


Studentët në protestë

### Kreu i qeverisë ka ripërsëritur dje thirrjen e tij për t'u ulur dhe biseduar

# Rama, studentëve: Mos u bëni si Luli në çadër, nuk kërkoj pazar

## "Nëse kemi ndërmend të jetojmë së bashku, duhet të dialogojmë"

Studentët kanë vijuar qëndresën e tyre për të 12 ditën me radhë, ndërsa kryeministri Edi Rama nëpërmjet një sërë komunikimesh në rrjetet sociale u ka kërkuar atyre në vazhdimësi edhe dje që të ulen në tryezën e bisedimeve dhe të dialogojnë. Edhe një herë kryeministri ka theksuar se është i gatshëm që t'i plotësojë të gjitha kërkesat e listuara nga studentët, por që kjo të bëhet e mundur, ai ka vënë theksin pikërisht te nevoja për të dialoguar. Rama ka publikuar një thënie të ish-zonjës së parë të SHBA-ve, politikanes, diplomates dhe aktivistes amerikane, Eleanor Roosevelt, ku evidentohet nevoja për të dialoguar, pavarësisht kundërshtive apo mendimeve të ndryshme që mund të kenë palët. "Ne duhet të përballemi me faktin që ose do të vdesim të gjithë së bashku, ose do të mësojmë të jetojmë së bashku dhe nëse kemi ndërmend të jetojmë së bashku, duhet të dialogojmë", citoi Rama Eleanor Roosevelt. Më vonë, në mungesë të një komunikimi të drejtpërdrejtë, kreu i qeverisë sërish përmes rrjeteve socialiste publikoi një foto nga protestat e ngjashme të studentëve në SHBA, ku ata i bënin thirrje qeverisë për dialog. Pra, ndryshe nga këtu në Shqipëri, ku ajo që bën thirrje për të biseduar është qeveria, dhe ata që refuzojnë bisedimet janë studentët. "Foto nga një protestë e famshme e studentëve në SHBA, ku pasi protestuan me këmbëngulje duke kërkuar dialog dhe transparencë, studentët arritën t'i ulin në tryezë autoritetet dhe morën një marrëveshje të favorshme", shkroi Rama. Nuk ka munguar edhe paralelizmat e tij me sjelljen e opozitës rreth dy vite më parë, teksa protestonte në çadër dhe refuzonte çdo lloj thirrjeje për dialog nga qeveria dhe faktori ndërkombëtar. Ndaj Rama u ka bërë thirrje studentëve që të mos bëhen si kreu i demokratëve, Lulzim Basha, që në atë kohë refuzonte çdo thirrje të tillë për dialog. Kjo pasi siç shprehet kryeministri, të gjithë e dinë rezultatin e asaj sjelljeje të opozitës në fund. "S'jeni Luli? Po atëherë bëni ekzaktësisht si Luli që futet në çadër e bërtet, s'dua dialog, plotëso kërkesat se s'dal nga çadra!? Ikën nga Kuvendi e bën të njëjtën gjë, plotësoji se s'vij! E pastaj në fund vetëm humbet! Kush ju kërkon pazare? Unë jo njëherë, as negociata! Dialog", thuhej në mesazhin e Ramës. Kryeministri më parë ka bërë të ditur se qeveria që ai drejton është e gatshme që të plotësojë të 8 kërkesat që paraqesin studentët, por duke vënë si kusht të vetëm dialogun për të përcaktuar së bashku një marrëveshje, ku të vendosin një kalendar të qartë të çdo veprimi që duhet të ndiqet për realizimin e tyre. Ai ka kërkuar nga studentët që të zgjedhin një përfaqësi dhe të ulen, qoftë edhe në sallën e parlamentit për të biseduar rreth të gjitha problematikave që ata kanë ngritur. Ndërkohë që nga ana tjetër, ai ka bërë përgjegjëse për këtë situatë edhe trupën drejtuese të universiteteve, të cilat sipas tij keqpërdorën autonominë që i ka dhënë qeveria.



**DIALOGU**

"S'jeni Luli? Po atëherë pse bëni ekzaktësisht si Luli që futet në çadër e bërtet, s'dua dialog, plotëso kërkesat se s'dal nga çadra!? Ikën nga Kuvendi e bën të njëjtën gjë, plotësoji se s'vij! E pastaj në fund vetëm humbet! Kush ju kërkon pazare? Unë jo njëherë, as negociata! Dialog".

### Kryemadhi, anëtarësisë: Zgjoni ndërgjegjen kombëtare

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, u bën thirrje të rinjve të Lëvizjes Rinore për Integrim t'i bashkohen protestës së studentëve. Në vijim të turit të saj të takimeve në rrethe, Kryemadhi ndaloi dje në Korçë, ku theksoi se sot është koha për ndryshim, ndaj çdo qytetar duhet të bëhet pjesë e protestës së studentëve. "Harroni kartën e anëtarësisë, harroni flamurin e partisë, futini në sirtar se do ju duhen për më vonë, por zgjoni ndërgjegjen kombëtare sepse kjo është më e rëndësishmja. Shqipëria po i thërret bijtë e saj. Vetëm rinia shqiptare mund t'i fusë të rinjtë, që të zgjojë jo vetëm klasën politike, por që të zgjojë të gjithë popullin, të zgjojmë prindërit, të zgjojmë vëllezërit, të zgjojmë gjyshërit, sepse jetojmë në minimumin e jetesës", deklaroi Kryemadhi gjatë takimit me strukturat e LSI-së në qytetin juglindor. Sipas saj, reforma në arsim ka dështuar dhe përgjegjës për këtë është Rama. Kryemadhi e cilësoi këtë muaj si vendimtar për të ardhmen e Shqipërisë madje, sipas saj, sot vihet në diskutim edhe vetë emri i Shqipërisë.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




"Kundër negociatave! Kërkojmë plotësimin e 8 kërkesave, luftë ndaj së ardhmes së dhunuar"

# Studentët nuk tërhiqen, protestë edhe sot para Kryeministrisë

## "Çdo qytetar shqiptar, i lirë të bashkohet me ne"



Studentët dje gjatë protestës para Kryeministrisë

Voltiza Duro

Studentët e universiteteve publike vazhdojnë të mos heqin dorë nga kauza e tyre, duke protestuar para Kryeministrisë deri në plotësimin e 8 kërkesave të tyre. Edhe dje, në ditën e 12 të protestës, të rinjtë me pankarta në duar e thirrje për arsim cilësor e ulje tarifash nuk janë tërhequr, pavarësisht kushteve klimaterike që s'janë aspak të favorshme. "Ne nuk do të tërhiqemi nga kauza studentore, bojkotimi i mësimit e protesta jonë do të vijojë deri në plotësimin e 8 pikave. Kushtet tona janë ta panegociueshme. Kërkojmë të miratohet përgjysmimi i tarifave në çdo nivel studimi, publikimin 'online' e të gjitha shpenzimeve për arsimin, rritjen në 50% të votës së studentëve për dekanët e rektorët. Jemi kundër çdo dialogu apo negociate. Thjesht kërkojmë plotësimin e kërkesave tona. Studentët e bashkuar do të luftojnë kundër një të ardhmeje të dhunuar", - tha njëra prej studenteve gjatë protestës.

**PARALAJMËRIMI**

Studentët kanë paralajmëruar një protestë masive ditën e sotme, si dhe u kanë bërë thirrje qytetarëve që t'u bashkohen. "Nesër çdo njeri që në portofol mban kartë ID që lexon shqiptar, të dalë në protestë", - ka bërë thirrje njëri prej studentëve protestues ditën e djeshme. Më tej, një studente ka theksuar se populli shqiptar duhet të reagojë më shumë ndaj sistemit. "Është për të ardhur keq, nuk duhet të protestojnë vetëm studentët, populli shqiptar po vuan, njerëzit kanë mijëra halle e pagat janë skandaloze. Pavarësisht të gjithave, ne nuk reagojmë, duhet të mësohemi që të reagojmë edhe më shumë. Vetëm qytetarët e lirë të këtij vendi duhet të vijnë. Protesta jonë nuk është politike, por luftojmë për kauza të drejta e demokratike", tha studentja. Sipas planifikimit, studentët nesër në orën 9.00 do të mblidhen para fakulteteve përkatëse e më tej do të grumbullohen para godinës së Kryeministrisë, ku do të ngrenë zërin sërish për problematikat e tyre. "Në orën 9-11, organizohemi përpara fakulteteve për të ndërgjegjësuar çdonjërin nga ne mbi kauzën tonë të drejtë. Studentët të pajisur me foni do të shpalosin në detaje kërkesat e tyre specifike për arsim cilësor. Folës të ndryshëm nga të gjitha programet e studimit dalin dhe denoncojnë me forcë problemet tona, padrejtësinë që na bëhen përditë, të cilat dukë het të marrin fund. Studentët artikulojnë kërkesa specifike për autoritetet drejtuese të fakulteteve/universiteteve. Përfaqësues nga fakultete/universitete të tjera përshëndesin protestën dhe prezantojnë problemet e përbashkëta", theksohet në njoftimin për protestën e ditës së 13-të. Edhe pedagogu Arlind Qori ka theksuar se duhet që qeveria duhet t'u bindet studentëve. "Fjala dialog nënkupton se logosi (arsyeja) gjendet diku ndërmjet palëve, të cilat duke dhënë e marrë, lëshojnë nga pak për të gjetur gjuhën e përbashkët. Në rastin tonë studentët janë bartësit e vetëm të logosit. Qeverisë i mbetet ose t'i bindet logosit, ose të përdorë dhunën. Rrugë tjetër s'ka", -thotë pedagogu.

**KËRKESAT**

Studentët kërkojnë: rritjen e buxhetit me 5% e GDP me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës, universitet/konvikt; transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe IAL-ve, publikimi i të gjitha shpenzimeve 'online'; rritjen nga 10% në 50% të peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekan, rektor dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në senatin akademik. Gjithashtu, ata kërkojnë edhe rishikim të titujve akademikë dhe verifikimin e plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore; pajisjen e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018-2019; ndërtimin e një biblioteke me standarde europiane dhe me libër universitar 'online', falas për studentët në gjuhën shqipe si dhe vlerësim të perfomancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikim i tij 'online' dhe regjistrimin e leksioneve. "Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat e Studentëve, Ligji i Arsimit të lartë, pika 2 kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-ve të ketë numër të barabartë votash si nga MASR dhe IAL-të si dhe të shtohet një përfaqësues në këtë bord nga studentët", - theksojnë studentët.

### BOJKOTI VAZHDON



"Ne nuk do të tërhiqemi nga kauza studentore, bojkotimi i mësimit e protesta jonë do të vijojë deri në plotësimin e 8 pikave. Kushtet tona janë të panegociueshme. Studentët e bashkuar do të luftojnë kundër një të ardhmeje të dhunuar", - tha njëra prej studenteve gjatë protestës.

### QEVERIA TË BINDET



"Fjala dialog nënkupton se logosi (arsyeja) gjendet diku ndërmjet palëve, të cilat duke dhënë e marrë, lëshojnë nga pak për të gjetur gjuhën e përbashkët. Në rastin tonë studentët janë bartësit e vetëm të logosit. Qeverisë i mbetet ose t'i bindet logosit, ose të përdorë dhunën. Rrugë tjetër s'ka", - thotë pedagogu.

## Studentët ironizojnë Ramën: "Jo kryeministër, por z.Meme"

Pavarësisht thirrjeve të shumta të kreut të qeverisë, Edi Rama për negociata e dialog, studentët nuk tërhiqen e madje në shumë raste edhe ironizojnë kryeministrin. "Edi Ramës mos i thirrni me kryeministër se është fjalë e gjatë. Ai është z. Meme", tha njëri prej studentëve gjatë protestës së djeshme. Një tjetër thekson se prej vitesh kërkojnë përmirësim të kushteve për studentët dhe cilësi në mësimdhënie, por sipas tij, kryeministri i vendit i ka hedhur në rrugë. "'Dialogun' me Naltmadhninë e kam provuar vetë, në shesh e në sarajet e tij, atëherë kur si fakultet na hodhi në rrugë. E sot, katër vjet më pas, 'dialogu' vazhdon. Jemi ende në rrugë!", - tha një tjetër student.

### 8 KËRKESAT E STUDENTËVE

**1-**Rritja e buxhetit me 5% e GDP, me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës, universitet/konvikt.
**2-**Transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe IAL-ve, publikimi i të gjitha shpenzimeve 'online'.
**3-**Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekan, rektor dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në senatin akademik.
**4-**Rishikim i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore.
**5-**Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat e Studentëve, Ligji i Arsimit të lartë, pika 2 kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-ve të ketë numër të barabartë votash si nga MASR dhe IAL-të si dhe të shtohen një përfaqësues në këtë bord nga studentët.
**6-**Pajisja e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018-2019 (të ndiqen nga bashkitë përkatëse).
**7-**Ndërtimi i një biblioteke me standarde europiane dhe me libër universitar 'online', falas për studentët në gjuhën shqipe.
**8-**Vlerësim i perfomancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikim i tij 'online' dhe regjistrimi i leksioneve.

# ZGJEDHJET NË PD
## REZULTATI

Partia Demokratike publikoi mbrëmë listën e fituesve për anëtarë të Keshillit Kombëtar të kësaj partie. Ne listen finale bien në sy emrat e ish zevëndëskryeministrit Gazmend Oketa si dhe ish deputetit Aleksander Biberaj. Por antarë të rinj të Keshillit Kombëtar janë edhe ish ministrat e qeverisë teknike si Dritan Demiraj, Ledia Mandija dhe Gazmend Bardhi. Po ashtu në listë janë edhe ish studentë të dhjetorit si Albert Kushu ndërkohë që të votuar janë edhe pjesa me e madhe e krerëve të departamenteve të Partisë Demokratike.

Ne listen e fituesve Oketa, Biberaj si dhe ish ministrat e qeverise teknike

# Emrat, kush jane antaret e rinj te Keshillit Kombetar te PD

*Fitues Premci, Kushti dhe Agustin Kola*

**KËSHILLI KOMBËTAR**
**VOTUAR NË KUVENDIN KOMBËTAR TË DATËS 15.12.2018**

- Adela Kryeziu
- Adriana Gjonaj
- Agest Kopellaj
- Agim Kukeli
- Agron Kuliçi
- Agron Musaraj
- Agustin Kola
- Ahmet Premci
- Ajshe Isha
- Akil Krajaa
- Alban Zeneli
- Albert Avduli
- Albert Kushti
- Albert Loci
- Albina Dede
- Aleksandër Biberaj
- Alfred Ahmetcenaj
- Alfred Rushaj
- Alfrida Marku
- Altin Meçe
- Andi Mustafa
- Andia Pustina
- Antoneta Çela
- Anxhela Malko
- Arben Beqiri
- Arben Ibroja
- Arben Muça
- Arben Ristani
- Ardian Isufi
- Ariana Malltezi
- Armand Teliti
- Artan Pogoni
- Arvit Bushati
- Asllan Dogjani
- Aulon Kalaja
- Aurel Bylykbashi
- Avenir Peka
- Avzi Ahmati
- Bardhyl Londo
- Benardeta Syku
- Bernard Banushi
- Besart Kadia
- Besnik Aliaj
- Bledi Kasmi
- Bujar Hoxha
- Bujar Vukaj
- Çelo Hoxha
- Çlirim Gjata
- Dardana Boletini
- Darien Xhindoli
- Dashnor Sula
- Denisa Vata
- Dorian Gjokmarkaj
- Dorjan Teliti
- Dritan Demiraj
- Dritan Shano
- Eda Grimci
- Edmond Biçoku
- Edmond Isaku
- Edona Staka
- Elvana Hana
- Emiliano Mone
- Endrin Gjipali
- Endrit Kokoshi
- Endrit Memiaj
- Eneida Guria
- Eneo Zguri
- Eni Kasmi
- Enkelejda Sallaku
- Enno Bozdo
- Enri Ceno
- Enriketa Papa
- Erald Kapri
- Erion Sula
- Eris Hoxha
- Eriselda Prishta
- Ermal Xhelilaj
- Ermir Gjeta
- Ervis Xhako
- Estela Gostivari
- Etion Kapedani
- Etleva Merko
- Fatbardh Kadilli
- Fatbardh Sallaku
- Fatjon Bathorja
- Fatmir Guda
- Fetah Hasanaj
- Fisnik Kruja
- Fisnik Qosja
- Fitim Zekthi
- Flamur Gjymishka
- Flamur Hoxha
- Florian Pustina
- Gazmend Dibra
- Gazmend Koduzi
- Gazmend Oketa
- Gazment Bardhi
- Gent Malko
- Gert Bogdani
- Gjergji Nika
- Gjok Uldedaj
- Gjok Vuksani
- Gramoz Nazëraj
- Greta Deljani
- Grigels Muçollari
- Haki Mustafa
- Haris Vongli
- Hysen Kadiu
- Hysen Xhura
- Hysni Ahmetaj
- Ibrahim Sako
- Igli Cara
- Ilir Dervishi
- Ina Vorfi
- Ina Zhupa
- Indrit Hoxha
- Indrit Vokshi
- Ines Nurja
- Irena Progni
- Irma Kopliku
- Irsida Shehi
- Ivi Bejtja
- Ivi Kaso
- Jamarbër Malltezi
- Jemin Gjana
- Jola Hysaj
- Jolio Dine
- Juela Hamati
- Julian Dedaj
- Juvina Qevani
- Kastriot Sulka
- Klodian Lata
- Klodjana Shala
- Kosta Barka
- Kreshnik Çollaku
- Kristi Koçibelli
- Laura Vorpsi
- Lealba Pelinku
- Lediana Fratari
- Ledina Mandia
- Liljana Cingu
- Liljana Elmazi
- Lindita Protoduari
- Lisander Hoxha
- Luan Hoti
- Luan Mustafaj
- Luigj Gjergji
- Luis Hoxha
- Lulzim Omuri
- Mal Berisha
- Marinela Ziu
- Martin Biba
- Mateo Spaho
- Megi Balliu
- Meri Poni
- Mersi Shehu
- Mimoza Hasekiu
- Minushe Lazaj
- Mirela Bogdani
- Mirela Karabina
- Mirela Tabaku
- Monika Qosja
- Murat Basha
- Myqerem Tafaj
- Nada Kallçiu
- Ndriçim Mehmeti
- Nevila Xhindi
- Niazi Kosovrasti
- Olsi Karapici
- Oriela Nebijaj
- Osman Metalla
- Patrik Sadikaj
- Paulin Marku
- Paulina Hoti
- Pëllumb Berisha
- Përparim Caca
- Petraq Milo
- Prel Gjoni
- Rajmonda


Suedi Sverige

INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

**INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA**

**TENDER NOTIFICATION**

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for **Workstations advanced** in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.
The tender dossier is available at http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ : from **November 28, 2018.**
The deadline for submission of tenders is: **December 27, 2018,** time **15:00** hrs, at Institute of Statistics of Albania, Str. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, 1017 Tirana, Albania.
Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ .
Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to 14 days before the date of submission of offers.

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

**NJOFTIM TENDERI**

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289"", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqsuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: *Workstations advanced.*

Dokumentat e tenderit mund ti gjeni në adresën: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ , nga data **28.11.2018**.
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **27.12.2018, ora 15:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, 1017 Tirana.
Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ .
Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në 14 ditë para ditës së fundit për dorëzimin e ofertave.


# Rikandidimi? Veliaj: Mezi e pres fushatën e ardhshme, e meritojmë



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i ftuar dje në emisionin "E Diela Shqiptare" e konsideron një fakt të kryer rikandidimin e tij për kryetar të Bashkisë së Tiranës, teksa shprehet se mezi i pret zgjedhjet e ardhshme. I ftuar në studion e "E Diela Shqiptare", Erion Veliaj nuk mund t'i shpëtonte pyetjes se si po i pret ai zgjedhjet, ndërsa u shpreh se priste një fushatë të qetë dhe pozitive. "Mezi e pres fushatën që të ballafaqohem me gjërat që kam bërë, por edhe për të shikuar alternativën që kanë të tjerët. Dhe unë besoj që ne duhet të kemi një fushatë të qetë, inkurajuese, frymëzuese për alternativat më të mira dhe do të isha shumë i lumtur për të parë alternativat e tjera për të korrektuar punën time", tha Veliaj. Ai u shpreh se meritonte të rikandidonte dhe kjo sipas tij, për shkak të punës që është bërë në Tiranë. "Por, kam shërbyer me shumë dashuri dhe besoj se e meritojmë që të vazhdojmë projektet që kemi nisur në Tiranë. Nuk bëhen të gjithë në një mëndje, për aq kohë sa ka një shumicë të drejtë, të ndershme, nuk pyet shumë për parti", u shpreh Veliaj. Ai foli edhe për protestën e studentëve, ndërsa e konsideroi jetike për realizimin e kërkesave të tyre dialogun. Sipas tij, protesta e studentëve solli në vëmendje të së gjithë shoqërisë një problematikë të mbartur prej vitesh dhe ku aktorët kryesorë të përkeqësimit të saj, sipas tij janë pikërisht ata që drejtojnë sot jetën universitare në vend.




Banorët e "Astirit" kanë protestuar sërish mbrëmë kundër prishjes së shtëpive

# Basha: Projekti i Unazës korruptiv, u manipulua plani urbanistik

## "Afera për nga të dhënat financiare i kalon 40 mln euro"

Banorët e Unazës në zonë e "Astirit" kanë dalë edhe dje në mbrëmje në protestë, duke bllokuar për gati 1 orë kalimin e automjeteve, ndërsa janë shprehur të vendosur për t'i shkuar deri në fund betejës së tyre për të mbrojtur banesat dhe bizneset që kërkohen të prishen nga projekti. Protestës iu bashkua sërish edhe kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i cili akuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë kryeministrin Edi Rama dhe kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj se kanë manipuluar planin urbanistik të kryeqytetit, pikërisht në zonën e Unazës. Sipas tij, çdo gjë është bërë në funksion të interesave të ngushta dhe ekonomike të kryeministrit. "Këtu tek Unaza e Re është konsumuar një krim i tretë, që përfshin drejtpërdrejt Erion Veliajn dhe Edi Ramën. Është manipuluar plani urbanistik i Tiranës për t'i hapur rrugë një skeme kriminale, e cila mbi gërmadhat, mbi shtëpitë që donin të prishnin këtu, do ndërtonin pallate shumëkatëshe me paratë e krimit të organizuar, me paratë e njerëzve që kanë bërë drogën dhe krimin e organizuar në Shqipëri", tha Basha. Ai shtoi se i gjithë projekti i Unazës së Madhe në zonën e "Astirit" është koruptiv, si sa i përket planit urbanistik, ashtu edhe përzgjedhjes së kompanive që kanë marrë përsipër ta ndërtojnë atë. Dhe sipas Bashës, askush nuk mund të merrte përsipër një koordinim të tillë, pa pëlqimin e vetë kryeministrit Edi Rama. "Kemi të bëjmë me një krim shtetëror, ku është i përfshirë nga i pari tek i fundit dhe nuk ka pikë dyshimi që i vetmi njeri që mund të garantojë dhe të koordinojë një vjedhje të tillë, të detyrojë gjithë këto organe shtetërore, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës, Bashkinë e Tiranës, të kryejnë veprime të tilla pa asnjë transparencë, pa asnjë konsultim është kryeministri Edi Rama. Edi Rama është drejtpërdrejt i përfshirë në këtë aferë. Është fakt i njohur botërisht dhe i publikuar nga mediat se Edi Rama e ka bërë këtë pazar kokë më kokë me të tria kompanitë", tha Basha. Kreu i opozitës theksoi gjithashtu se pjesë e kësaj skeme korruptive është bërë edhe kryeprokurorja, që vazhdon të heshtë para fakteve që janë bërë publike. "Është e njëjta Arta Marku, e cila urdhëron vartësit e saj të arrestojnë, të mbajnë në paraburgim qytetarë që dalin të mbrojnë shtëpitë e tyre, është e njëjta që i ka mbushur burgjet me fukarenj, por që nuk ka arrestuar akoma asnjë zyrtar për këtë vepër korruptive, për këtë vjedhje, e cila ka shtangur shqiptarët, Evropën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës", u shpreh Basha. Ai shtoi se PD po mbledh edhe të dhëna rreth kësaj çështjeje dhe se shumë shpejt do t'i bëjë ato publike. "Siç ju kam paralajmëruar para disa ditësh, ne po mbledhim të dhëna zyrtare për këtë aferë kriminale, që për nga të dhënat financiare i kalon 40 mln euro. Plani është të vidhet dyfish. Rama dhe Veliaj kanë ndryshuar planin urbanistik të qytetit që eksponentë të krimit të pastrojnë paratë e krimit dhe t'i ndajnë me Edi Ramën dhe shpurën e korruptuar. Brenda dy ditëve të ardhshme do të keni në dispozicion dokumentet zyrtare që konfirmojnë këtë", - theksoi kreu i PD. Basha konfirmoi mbështetjen edhe për protestën e studentëve. "Protesta që i ka vënë vulën gjendjes së emergjencës kombëtare është protesta e studentëve shqiptarë. Kryengritja e dytë studentore shqiptare e dhjetorit 2018 është shprehja më e çiltër dhe më e drejtpërdrejt e revoltës që qytetarët kanë. Rinia shqiptare u ngrit dhe me kurajën e saj po vret frikën nga dita në ditë", - tha Basha.



**AKUZA**

"Nuk ka pikë dyshimi që i vetmi njeri që mund të garantojë dhe të koordinojë një vjedhje të tillë, të detyrojë gjithë këto organe shtetërore, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës, Bashkinë e Tiranës të kryejnë veprime të tilla pa asnjë transparencë, pa asnjë konsultim është kryeministri Edi Rama".

## Banorët e Bregut të Lumit, në protestë: Kërkojmë ballafaqim me Ramën

Ashtu si çdo mbrëmje tjetër të këtyre javëve të fundit, banorët e Bregut të Lumit kanë dalë sërish pasditen e djeshme në protestë për mungesën e dëmshpërblimeve nga realizimi i projektit të ndërtimit të Bulevardit të Ri. Banorët thanë se do mbrojnë pronën e ndërtuar me djersën e tyre, ndërsa i kërkuan kryeministrit ballafaqim. "Nëse është burrë kryeministri, le të vijë e të ballafaqohet. Pa popull nuk ka kryeministër. Kryeministri pa taksat tona nuk jeton dot. Këto shtëpi i kemi ngritur me gjak, me djersë rrugëve në emigracion", tha njëri prej banorëve. Protestën e tyre e




mbështetën edhe deputetët e Partisë Demokratike, të cilët kërkuan nga qeveria të dëgjojë zërin e tyre. "Dua t'ju shpreh mbështetjen e PD dhe lidershipit të saj, Lulzim Basha. Keni plot 12 ditë që jeni këtu dhe nuk po kërkoni asgjë më shumë e asgjë më pak se një takim me ata njerëz që paguhen me taksat tuaja. Ata njerëz që e kanë detyrim të përgjigjen. PD nuk do lejojë që paratë e qytetarëve shqiptarë të vidhen dhe të futen në xhepat e qeveritarëve. Fakti që nuk vijnë t'ju takojnë tregon se shteti ka rënë, sistemi ka rënë. Dua t'ju kërkoj që të bashkoheni me studentët, me fëmijët tuaj që i kthyen shpresën këtij vendi dhe bashkë me ta të rrëzoni qeverinë e krimit. Të gjithë ju keni një të përbashkët, kundërshtarin. Ai është korrupsioni, vjedhja, Edi Rama. Vazhdoni, qëndroni, ne do të na keni këtu", deklaroi deputeti i PD-së, Klevis Balliu.

**LSI DENONCON PRESIONIN E DREJTORESHËS SË "SAMI FRASHËRIT"**

Deputetja e LSI-së, Floida Kërpaçi, në një dalje për media ka denoncuar drejtoreshën e "Sami Frashërit", Teuta Dobi, për shantazh ndaj të rinjve. "Jemi në këtë deklaratë për shtyp për të denoncuar publikisht drejtoreshat e Rilindjes, të cilat në vend të mbështesnin gjimnazistët e lirë dhe kërkues të të drejtave të tyre, kërcënojnë, ofendojnë dhe intimidojnë gjimnazistët e vendit tonë! Presioni psikologjik do të shoqërohet me padi kundrejt teje dhe do të vazhdojmë me çdo drejtoreshë tjetër, e cila ndjek modelin e kërcënimit të të rinjve!", tha Kërpaçi.

## Krybashkiaku: Unaza e Re jetike, në fund të gjithë do të jenë të kënaqur

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj e ka konsideruar jetike për qytetin, zbatimin e projektit për ndërtimin e Unazës së Re, përfshi edhe zgjerimin e saj në zonën e "Astirit". Sipas tij, çdo qytet i madh ka një Unazë të tillë, që i jep frymëmarrje trafikut të makinave. "Unaza e Re është jetike për Tiranën. Në çdo qytet, në Londër, Berlin, Uashington, në çdo qytet të madh fjala 'ring road' është sinonim i një kryeqyteti. S'ka kryeqytet, nëse s'ka një Unazë të Madhe", tha Veliaj. Ai theksoi se Unaza përveçse është një proces ndërtimi, është edhe një proces i akomodimit social të banorëve që preken prej saj. "Dakordësia që kemi arritur sot është që Unaza duhet, por edhe njerëzit nuk duhen lënë në rrugë. Kjo është arsyeja pse shumë pranë jush këtu janë banesat sociale, ku një pjesë e madhe e familjeve që nuk kanë një apartament, sepse ka pasur dhe raste që kanë pasur 7 pallate, tani për 7 pallate unë s'jap dot banesë sociale, por për dikë që ka pasur vetëm atë dhe mund ta ketë ndërtuar në ato vitet e kaosit mbi kolektorin e kanaleve të ujërave të zeza sot është më mirë te banesat sociale. Për pjesën tjetër ka një pagesë cash", tha Veliaj. Sipas tij, pavarësisht debateve që kanë shoqëruar këtë proces, në fund të gjithë do jenë të kënaqur nga zhvillimi i këtij projekti. "Unë besoj që ato familje, por edhe ne që dhamë të gjithë nga një dorë për të gjetur gjuhën e përbashkët do të jemi krenarë kur Unaza të jetë bërë dhe të themi, më në fund një qytet për së mbari edhe kur vjen puna te trafiku", shtoi Veliaj.

# PENSIONISTËT
## SHPËRBLIMI

Qeveria propozon rritje pensioni për disa kategori që kanë kryer punë të rënda

# Projektligji i plotë për pensionet, masa e përfitimit për çdo kategori

## *Mosha, kriteret dhe dokumentet*


Pensionistë (foto ilustruese)

Të gjithë ata që kanë kryer punë të vështira duke punuar në miniera në nëntokë, në sektorin e naftës apo edhe në metalurgji do të kenë një trajtim më të mirë financiar, mbi masën e pensionit të pleqërisë. Ministria e Financave ka paraqitur për diskutim një projektligj të ri, që trajton të gjitha këto kategori me pension suplementar, duke bërë të mundur që masa e përfitimit financiar të tyre t'i përgjigjet jo vetëm punës së vështirë që kanë bërë në të shkuarën, çka ka ndikuar në shëndetin dhe jetëgjatësinë e tyre, por edhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve që kanë përfituar kategoritë e tjera të pensionit. Në total nga kjo nismë pritet të përfitojnë rreth 26 mijë persona, ndërsa masa e përfitimit do të variojë nga 0.6 për qind deri në 1 për qind për çdo vit pune të njohur si punë e vështirë, pra në profesionin e minatorit, naftëtarit apo metalurgut. Me 0.6 për qind u rritet pensioni atyre që kanë punuar në sektorin e naftës dhe metalurgjisë, ndërsa me 1 për qind për çdo vit pune u rritet atyre që kanë punuar në miniera. Kështu, nëse një person ka 25 apo 30 vite punë të siguruara dhe nga këto 15 vite i ka punë në minierë, atëherë ai do ketë mundësi që të përfitojë një rritje pensioni me 15 për qind mbi vlerën e pensionit të pleqërisë. Masa e përfitimit rritet me rritjen e viteve që një person ka punuar në minierë. Po ashtu, e njëjta logjikë ndiqet dhe për ata që kanë punuar në naftë apo metalurgji, por me një masë prej 0.6 për qind rritje për çdo vit. Ndërkohë që projektligji bën dhe një përcaktim më të saktë edhe të moshës së pensionit për secilën prej këtyre kategorive, duke njohur diferencimin mes burrave dhe grave. Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë që hyjnë në kategorinë e parë, mosha për burrat për të dalë në pension është 55 vjeç dhe për gratë 50 vjeç, ndërsa periudha e përgjithshme e sigurimit respektivisht do jetë 30 vjet dhe 25 vjet. Nga këto, vjetërsia në punë të kategorisë së parë do jetë 15 vjet për burrat dhe 12.5 vjet për gratë. Ndërsa për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të kategorisë së dytë, mosha e daljes në pension do jetë 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë. Ndërkohë që periudha e sigurimit të përgjithshëm do jetë 30 vjet për burrat dhe 25 vjet për gratë, ndërsa vjetërsia në punë do jetë respektivisht 20 dhe 15 vjet.




## Numri i përfituesve për çdo profesion



Në relacionin që shoqëron projektligjin që mban firmën e ministrit të Financave, Arben Ahmetaj janë përllogaritur edhe numri konkret i përfituesve dhe kostoja që ky ligj do të sjellë në buxhetin e shtetit, nëse do të zbatohet. Kështu, referuar kushteve për pension, bazuar në të dhënat që disponohen, si dhe në numrin aktual të punësuarve në industrinë e naftës, parashikohet që numri i personave që përfitojnë të arrijë në rreth 7000, nga 9900 që përllogaritej të ishte para ndryshimeve, me një efekt financiar vjetor rreth 750 milionë lekë. Në projektligjin fillestar, efektet financiare ishin parashikuar rreth 400 milionë lekë. Pra, me këtë rishikim vlera vetëm për kategorinë e naftëtarëve është rritur me rreth 350 milionë lekë në vit. Ndërkohë që numri i përfituesve minatorë parashikohet të jetë rreth 16 mijë persona dhe efekti përllogaritet rreth 530 milionë lekë në vit, ndërsa për metalurgjinë numri i përfituesve parashikohet të jetë rreth 2500 me një efekt financiar rreth 250 milionë lekë.

## PROJEKTLIGJI I PLOTË

**Neni 1**
**Qëllimi**
Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji.

**Neni 2**
**Përfituesit**
Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat që kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kur kanë punuar në punë dhe profesione, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, si më poshtë:
a) Pensionistët, që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
b) Pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë" .
c) Punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë.
ç) Punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhimit, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, përpunimit dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës.
d) Punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje, sipas përcaktimeve në kreun III, VII dhe XIII të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".

**Neni 3**
**Vjetërsia në punë dhe periudhat e sigurimit**
Për efekt të zbatimit të këtij ligji, vjetërsia e përgjithshme në punë dhe periudhat e sigurimit, vlerësohen dhe njihen sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të akteve ligjore në zbatim të tij.
Për efekt të përfitimeve nga ky ligj, vjetërsia në punë dhe periudhat e sigurimit në profesionet dhe punë në miniera në nëntokë, në industrisë së naftës dhe të gazit, dhe në metalurgji do të njihen si me poshtë:
a) Periudhat e punës të kryera në miniera në nëntokë, sipas dispozitave të kreut I te XIII dhe XIV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 20.12.1958 "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni", të ndryshuar.
b) Periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit në profesione dhe punë e përcaktuar në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".
c) Periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit nga personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në industrinë e naftës dhe gazit drejtpërdrejt në prodhim në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhimit, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, përpunimit dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës.
d)Periudhat e punës të kryera në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje sipas përcaktimeve në kreun III, VII dhe XIII në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".
Pas datës 30.09.1993, proceset e punës në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji do të njihen për efekt përfitimi sipas këtij ligji, kur ato janë kryer dhe janë dokumentuar, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e sipërshënuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik, në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror si dhe në subjekte private. Ndryshimet nga përcaktimet në vendimin e sipërshënuar në emërtimet e profesioneve dhe punëve që janë si shkak i ndryshimeve të teknologjisë, ndryshimeve të organizimit dhe pronësisë së kapitaleve, përcaktohet me VKM.
Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen periudha në profesion sipas pikës 3, vetëm kur është paguar kontributi sipas nenit 6, të këtij ligji. Periudhat e sigurimit të pa mbuluara me kontribute të paguara në fondin e sigurimeve shoqërore nuk njihen të vlefshme për këtë ligj.

**Neni 4**
**Llojet e përfitimit**
Personave të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si më poshtë:
a) Pension për shkak të profesionit (llojit të punës).
b) Shtesë mbi pensionin e pleqërisë.
c) Shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

**Neni 5**
**Kushtet dhe masa e pensionit për shkak të profesionit**
Ish punonjësit e përcaktuar në nenin 2, të cilët kanë periudha sigurimi sipas përcaktimeve në nenin 3 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimeve të pensionit për shkak të profesionit apo shtesës mbi pension, kur plotësojnë kushtet si më poshtë:
I. Periudha e sigurimit dhe vjetërsia e punës në profesion.
a) Për ish-punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë, trajtimi me përfitime përpara moshës dhe kushteve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të vazhdojë të bëhet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 150/2014 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
b) Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 1 "punë, që hyjnë në kategorinë e parë", kreu IV pika 2 dhe 3 të vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni" i ndryshuar, përcaktohet:
1) Mosha: për burrat 55 vjeç, për gratë 50 vjeç.
2) Periudha përgjithshme e sigurimit: për burrat 30 vjet, për gratë 25 vjet.
3) Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 15 vjet, për gratë 12.5 vjet.
c) Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 2, "punë që hyjnë në kategorinë e dytë" kreu IV, në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni" i ndryshuar, dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, sipas listës së miratuar me VKM.
1) Mosha: për burrat 60 vjeç, për gratë 55 vjeç.
2) Periudha e sigurimit: për burrat 30 vjet, për gratë 25 vjet.
3) Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 20 vjet, për gratë 15 vjet.
Kur nuk plotësohen kushtet e pikës "1" periudha e punës sipas asaj pike, i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në pikën "2". Në këtë rast kushtet e përfitimit janë ato sipas pikës 2-të më sipër shënuar.
d) Ish-punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje sipas përcaktimeve në kreun III, VII dhe XIII në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".
1) Mosha: për burrat 60 vjeç, për gratë 55 vjeç.
2) Periudha e sigurimit: për burrat 30 vjet, për gratë 25 vjet.
3) Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 20 vjet, për gratë 15 vjet.
II. Masa e përfitimit.
Masa e përfitimit mujor për të gjithë personat që plotësojnë kushtet sipas pikës i të këtij neni, llogaritet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**Neni 6**
**Masa e përfitimit e shtesës mbi pensionin**
I. Masa e përfitimit:
Ish punonjësit, sipas përcaktimeve në këtë ligj të cilët kanë përfituar, ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfitojnë shtesë pensioni për çdo vit periudhe sigurimi në profesion sipas përcaktimeve në nenin 3, si më poshtë:
a. Punonjësit e nëntokës, 1% e masës së pensionit të pleqërisë.
b. Punonjësit e industrinë së naftës e gazit dhe punonjësit e metalurgjisë 0,6 % e masës së pensionit të pleqërisë.
II. Masa e përfitimit për invalidët:
Përfituesit, sipas përcaktimeve në këtë ligj, të cilët kanë përfituar ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension invaliditeti sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension në masën 1% për çdo vit vjetërsi pune në miniera në nëntoke, industrinë e naftës dhe në metalurgji, sipas përcaktimeve në nenin 3 të këtij ligji.



Kategoritë përfituese. Astrit Hado: Mund ta merrni 50 mijë lekëshin edhe në 2019-ën

# Kreu i ISSH: Nga sot mund të tërhiqni shpërblimet e fundvitit

## *Grafiku i plotë me datat për pensionistët*

Voltiza Duro

Duke filluar nga dita e sotme, pensionistët mund të tërheqin shpërblimet e fundvitit në masën prej 50 mijë lekësh të vjetra. "Gazeta Shqiptare" publikon sot kalendarin përkatës, bazuar në datat kur të moshuarit tërheqin pensionet. Ditën e djeshme, kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado nëpërmjet një njoftimi zyrtar ka bërë me dije se ky grafik është krijuar për të dhënë në kohë shpërblimin. "Mbështetur në VKM nr. 732, datë 12.12.2018 'Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit, 2018', Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Postën Shqiptare sha., duke filluar nga dita e hënë, datë 17 dhjetor 2018, do të fillojë pagesën e shpërblimit të festave të fundvitit për pensionistët, në masën 5,000 lekë. Për të realizuar në kohë dhe me korrektësi dhënien e këtij shpërblimi është realizuar një grafik në të gjitha qendrat paguese të postës. Sipas këtij grafiku, të miratuar për këtë qëllim, do të punohet me orar veprimi nga ora 7.30 deri në orën 20.00, çdo ditë, duke filluar nga data 17.12.2018", - thekson Hado. Më tej ky i fundit shton se tashmë fondet janë transferuar në Postën shqiptare sha. "Çdo ditë, deri në orën 14:00 do të realizohet pagimi i pensionit dhe shpërblimi për ata pensionistë që kanë datën e tërheqjes së pensionit dhe pas kësaj ore do të paguhet shpërblimi për pensionistët që e kanë tërhequr pensionin para kësaj date, sipas grafikut të mëposhtëm. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka gjeneruar shpërblimin në sistemin informatik dhe gjithçka është gati në portalin e pagesave për t'u paguar, për të gjithë përfituesit. Njëkohësisht janë garantuar dhe transferuar fondet te Posta Shqiptare sha., si agjent pagues", - thuhet në njoftim. Sipas grafikut, pensionistët mund ta tërheqin shpërblimin e fundvitit deri në 29 dhjetor, ndërsa ata që s'mundën ta merrnin brenda kësaj date, do e tërheqin së bashku me pensionin e muajit janar 2019-të. "Pensionistët që e tërheqin pensionin pranë bankave të nivelit të dytë, në datën e pagesës së pensionit 20.12.2018, do t'iu transferohet edhe masa e shpërblimit. Për pensionistët që e tërheqin pensionin në zyrat postare në fshatra, shpërblimi do të paguhet sipas datave të pagesës së pensioneve, duke filluar nga data 18 dhjetor e në vazhdim. Grafiku i shpërndarjes së pagesave është dakordësuar midis ISSH-së dhe Postës Shqiptare sha. Të gjithë ata që nuk do të mund ta tërheqin këtë shpërblim deri më 29 dhjetor, do të mund ta marrin atë bashkë me tërheqjen e pensionit në muajin janar 2019 e në vazhdim, pasi faturat janë të gjeneruara", - nënvizon kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.


Kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado

**SHPERBLIMI**



"Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Postën Shqiptare sha., duke filluar nga dita e hënë, datë 17 dhjetor 2018, do të fillojë pagesën e shpërblimit të festave të fundvitit për pensionistët, në masën 5,000 lekë. Për të realizuar në kohë dhe me korrektësi dhënien e këtij shpërblimi është realizuar një grafik në të gjitha qendrat paguese të postës", - thekson Hado.

| Data e pagesese se shperblimit | | Pensionistet e dates/datave |
|---|---|---|
| 17.12.2018 | 17.12.2018 dhe | 3 dhjetor 2018 |
| 18.12.2018 | 18.12.2018 dhe | 4 dhjetor 2018 |
| 19.12.2018 | 19.12.2018 dhe | 5 dhjetor 2018 |
| 20.12.2018 | 20.12.2018 dhe | 6 dhjetor 2018 |
| 21.12.2018 | 21.12.2018 dhe | 7 dhjetor 2018 |
| 22.12.2018 | 22.12.2018 dhe | 10 dhjetor 2018 |
| 24.12.2018 | 24.12.2018 dhe | 11 dhjetor 2018 |
| 25.12.2018 | 25.12.2018 dhe | 12 dhjetor 2018 |
| 26.12.2018 | 26.12.2018 dhe | 13 dhjetor 2018 |
| 27.12.2018 | 27.12.2018 dhe | 14 dhjetor 2018 |
| 28.12.2018 | 28.12.2018 | dhe ata që kanë mbetur pa tërhequr |
| 29.12.2018 | 29.12.2018 | dhe ata që kanë mbetur pa tërhequr |

### KATEGORITË PËRFITUESE

Përkatësisht 50 mijë lekëshin do e marrin të gjithë personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social. Të drejtën për të përfituar shpërblimin në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të pensionit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

"Shpërblimin e fundvitit e marrin edhe individët që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, 'Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë' dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar", - theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Edhe personat që marrin pension, sipas ligjit nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar kanë të drejtë të marrin shpërblimin e fundvitit. Ndërkohë këtë të fundit mund ta tërheqin edhe personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Kategoria e fundit e individëve që mund të marrë shpërblimin prej 50 mijë lekësh të vjetra është ajo e personave që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, 'Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar'", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

**50**

**MIJË LEKË SHPËRBLIM**

Brenda muajit dhjetor, pensionistët në mbarë vendin do të marrin 50 mijë lekë të vjetra shpërblim për festat e fundvitit. Ky vendim është marrë ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave dhe është miratuar nga kryeministri i vendit, Edi Rama.




**PAGESAT**

"Çdo ditë, deri në orën 14:00 do të realizohet pagimi i pensionit dhe shpërblimi për ata pensionistë që kanë datën e tërheqjes së pensionit dhe pas kësaj ore do të paguhet shpërblimi për pensionistët që e kanë tërhequr pensionin para kësaj date, sipas grafikut të mëposhtëm", - thotë Hado




**FONDI**

"Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka gjeneruar shpërblimin në sistemin informatik dhe gjithçka është gati në portalin e pagesave për t'u paguar, për të gjithë përfituesit. Njëkohësisht janë garantuar dhe transferuar fondet te Posta Shqiptare sha., si agjent pagues", - thuhet në njoftim.

Vetëpërjashtojnë të dënuarit për dhunë në familje e trafikim

# 64 të dënuarit në burgun e Reçit kërkojnë zgjerim të amnistisë

## *Letra për ministren Gjoni: Të falen 18-vjeçarët*

Pas të burgosurve në burgjet e Drenovës dhe Burrelit, edhe të burgosurit e burgut të Reçit në Malësinë e Madhe i janë drejtuar ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj dhe Presidentit Meta, me një peticion ku i kërkojnë zgjerimin e amnistisë me rastin e festave të fundvitit. Persona që vuajnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Reç në kërkesën e tyre ashtu si bashkëvuajtësit e tyre në burgjet e tjera të vendit e bazojnë te vendimet e padrejta të gjykatave. "News 24" ka siguruar kërkesën e të burgosurve të Reçit, ku ndër të tjera thuhet:

"E nderuar ministre, duke qenë se në sistemin gjyqësor kemi marrë vendime të padrejta dhe abuzive dhe në pamundësi për rishqyrtimin e të gjitha dosjeve, kërkojmë nga ana juaj që amnistia të prekë të gjitha kategoritë e të dënuarve, përjashtuar të dënuarit për terrorizëm, ata për dhunë në familje, përdhunim dhe shfrytëzim prostitucioni". Peticioni mban firmën e 64 të dënuarve në burgun e Reçit, shumica prej të cilëve nuk përfshihen në amnistinë e paralajmëruar për festat e fundvitit. Drafti i paraqitur, i cili ende nuk është miratuar parashikon amnisti për 900 të burgosur, ku përfshihen të dënuarit deri në tri vite, që kanë marr vendimin e formës së prerë deri më 30 nëntor 2018; ata që iu ka mbetur edhe dy vite nga dënimi, për femrat mbi 50 vjeç dhe për meshkujt mbi 60 vjeç. Amnistohen gjithashtu personat të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë 18 vjeç, ose më pak se kaq. Ndërkohë përjashtohen nga amnistia të dënuarit për krime kundër njerëzimit, për krime seksuale, vepra penale kundër, moralit, dinjitetit, fëmijëve dhe familjes. Po ashtu, nuk përfshihen në draftin e amnistisë personat që kanë kryer krime zgjedhore dhe ata, të cilët i janë shmangur drejtësisë.



**PETICIONI**

"E nderuar ministre, duke qenë se në sistemin gjyqësor kemi marrë vendime të padrejta dhe abuzive dhe në pamundësi për rishqyrtimin e të gjitha dosjeve, kërkojmë nga ana juaj që amnistia të prekë të gjitha kategoritë e të dënuarve, përjashtuar të dënuarit për terrorizëm, ata për dhunë në familje, përdhunim dhe shfrytëzim prostitucioni".

SHKURT

## Dhunoi të miturin, pranga 46-vjeçarit nga Bulqiza



Një 46-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi akuzohet për keqtrajtim të një të mituri. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin me inicialet Xh.V., banues në Bulqizë. Mësohet se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë e ka dënuar këtë shtetas me 6 muaj burg, për veprën penale "Keqtrajtim të të miturit". Materialet procedurale do t'i referohen prokurorisë për veprime të mëtejshme.

## Lista e zezë me të kërkuarit në qarkun e Lezhës



Publikohet "lista e zezë" e person ave më të kërkuar për qarkun e Lezhës. Policia e Shtetit ka bërë të njohur ditën e sotme emrat e më të rrezikshmëve, që rezultojnë të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale. "Ja personat më të kërkuar nga policia në qarkun Lezhë. Policia e Shtetit fton cilindo që ka dijeni mbi vendndodhjen e tyre të telefonojnë policinë në numrin pa pagesë 112, apo aplikacionin 'Komisariati dixhital', duke ju garantuar anonimatin. Ndihmo edhe ti në sigurinë publike", thuhet në njoftimin e Policisë Shtetit.



## Aksidentohet autobusi në Zvicër, mes të plagosurve edhe 2 shqiptarë

Një autobus i nisur nga Xhenova e Italisë është përfshirë në një aksident në Zyrih të Zvicrës. Sipas mediave vendëse, një grua ka humbur jetën dhe 44 pasagjerë të tjerë janë plagosur. Tre nga të plagosurit ndodhen në gjendje të rëndë, mes të cilëve janë dy shoferët. Ndër personat që kanë pësuar lëndime janë edhe dy shqiptarë. Mediat italiane shkruajnë se në bordin e autobusit ishin të paktën 13 italianë, 2 shqiptarë, 1 zviceran, 1 gjerman, 2 kolumbianë, 1 jordanez, 1 rumun, 1 boshnjak, 6 rusë dhe 3 afrikanë. Identiteti i dy shqiptarëve nuk është bërë i ditur. Shkaqet e aksidentit janë të paqarta, megjithatë paraprakisht dyshohet të ketë ndodhur për shkak të kushteve të këqija atmosferike dhe ngricës në rrugë.


SHPALLJE ANKANDI

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më date **24.12.2018 ora 8ºº - 16ºº** në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, **Arë** me sipërfaqe totale **1500 m²** me numër pasurie 6/90, volumi 9, faqe 174, zona kadastrale 1879, e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlere fillestare në ankand 15.876 (Pesëmbëdhjetmijë e tetëqind e shtatëdhjet e gjashtë) EUR.
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 *Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*" s**hpall 1 (një) vend vakant për "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT:**
a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**
· Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
· Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:**

· Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
· Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
· Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike,** nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## *ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj*

Këshilli i Ministrave ka miratuar pardje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

**AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE**
**LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT**

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 637 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 638 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 639 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| ISMET | SHERIF | MANA | 640 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 490.1 | 12,764 | 6,255,636.40 |
| | | | 641 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 642 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 643 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| SEFEDIN | HALIM | HASA | 644 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 472.4 | 12,764 | 6,029,713.60 |
| | | | 645 | AHMET | | ZENELHOXHA | | | |
| BAJRAM | HASAN | MUÇA | 646 | KAMBER | | MEHJA | 319.70 | 12,764 | 4,080,650.80 |
| ARBEN | SABRI | KUKA | | | | | | | |
| YMER | XHELAL | ELEZI | | | | | | | |
| NDERIM | YMER | ELEZI | 647 | MEHMET | SULEJMAN | MITARJA | 568.50 | 12,764.00 | 7,256,334.00 |
| MEVLAN | BEDRI | KAZA | 648 | MUSTAFA | | BYLYKBASHI | | | |
| DRITAN | BEDRI | KAZA | 649 | HYQMET | | XHERRI | | | |
| | | | 650 | LINDITA | | QEVANI | | | |
| | | | 651 | MERITA | | KARAJ | | | |
| | | | 652 | MATEO | | XHERRI | | | |
| | | | 653 | EMIN | | XHERRI | | | |
| | | | 654 | VALBONA | | QEVANI | 478.70 | 12,764 | 6,110,126.80 |
| REFAT | SHAHIN | PISHA | | | | | | | |
| NAIM | ISLAM | KAÇULI | 655 | MAHMUT | | DORACI | 917.50 | 12,764.00 | 11,710,970.00 |
| | | | 656 | MUSTAFA | | BYLYKBASHI | | | |
| | | | 657 | HYQMET | | XHERRI | | | |
| | | | 658 | LINDITA | | QEVANI | | | |
| | | | 659 | MERITA | | KARAJ | | | |
| | | | 660 | EMIN | | XHERRI | | | |
| RAMAZAN | SELIM | LEKA | 661 | VALBONA | | QEVANI | 106.30 | 12,764 | 1,356,813.20 |
| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi I Pronarëve | | | | | |
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| TIRANE JUG | | | | | | | | | |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 2776 | | | | | | | | | |
| | | | 662 | QERIM | SELMAN | SHEHU | | | |
| | | | 663 | GANI | HAKI | MANCAKU | | | |
| | | | 664 | FIQIRI | HAKI | MANCAKU | | | |
| | | | 665 | NAXHIJE | | EGRO | | | |
| | | | 666 | ASIM | SHAQIR | DERVISHI | | | |
| | | | 667 | SADETE | HAKI | TOPI | | | |
| BARJAM | ISMAIL | ALLKOCI | 668 | FATBARDHA | | SHPENDI | 354.00 | 878 | 310,812.00 |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3866 | | | | | | | | | |
| ANTON | HILE | PJETRI | 669 | DONILDA | VIKTOR | SULAJ | 27.67 | 4,242 | 117,376.14 |
| MEJTE | MUHARREM | SHIMA | | | | | | | |
| MUHARREM | GANI | DERVISHI | 670 | SHYQYRI | ADEM | VRAPI | 500.00 | 4,242 | 2,121,000.00 |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8180 | | | | | | | | | |
| | | | 671 | AIDA | SHABAN | REPISHTI | | | |
| | | | 672 | EMA | SHABAN | PREZA | | | |
| | | | 673 | ARTUR | SHABAN | DAJA | | | |
| | | | 674 | FLAMUR | XHEMAL | KALLCIU | | | |
| | | | 675 | FATBARDH | XHEMAL | KALLCIU | | | |
| | | | 676 | GEZIM | XHEMAL | KALLCIU | | | |
| | | | 677 | ARGJENT | XHEMAL | KALLCIU | | | |
| | | | 678 | SUZANA | XHEMAL | DEMNERI | | | |
| | | | 679 | FATIME | XHEMAL | MYDERIZI | | | |
| | | | 680 | RAIMONDA | BESIM | MYDINLLAR | | | |
| | | | 681 | PALMIRA | BESIM | DAJA | | | |
| | | | 682 | ARJAN | BESIM | DAJA | | | |
| | | | 683 | HATIXHE | MEHMET | DAJA | | | |
| | | | 684 | QEMAL | MEHMET | DAJA | | | |
| MAKSIM | DILAVER | RUZAJ | 685 | HAMIDE | MEHMET | CASLLI(DAJA) | 53.17 | 31,270 | 1,662,625.90 |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 2380 | | | | | | | | | |
| PERPARIM | XHEVDET | TAKAJ | 686 | SHPETIM | SHABAN | KARAI | 488.60 | 507 | 247,720.20 |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3321 | | | | | | | | | |
| | | | 687 | CEZAR | | BESHIRI | | | |
| | | | 689 | PETRIT | | BESHIRI | | | |
| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 690 | BESIM | | BESHIRI | | | |
| | | | 691 | DIANA | | BESHIRI | | | |
| | | | 692 | VEHAT | | ISMAILATI | | | |
| | | | 693 | VALBONA | | ISMAILATI | | | |
| | | | 694 | ELVIS | | ISMAILATI | | | |
| | | | 695 | SYRJA | | BESHIRI | | | |
| | | | 696 | ARBEN | | BESHIRI | | | |
| | | | 697 | ELIDA | | BESHIRI | | | |
| | | | 698 | EDLIRA | | BESHIRI | | | |
| | | | 699 | VILFRID | | ZAVALANI | | | |
| | | | 700 | ALBAN | | XHILLARI | | | |
| | | | 701 | SUZANA | | HOSHI | | | |
| | | | 702 | FIQIRET | | ISMAILATI | | | |
| | | | 703 | LIRI | | HYDI | | | |
| | | | 704 | ISMET | | KRYEZIU | | | |
| | | | 705 | EVA | | SHEHDULLA | | | |
| KOZMA | VELI | DULE | 706 | SKENDER | | ISMAILATI | 194.00 | 2,560 | 496,640.00 |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8190 | | | | | | | | | |
| BESNIK | HAMIT | KOLAVERI | 707 | LIZA | | MATI(ARYA)IRMA | 257.60 | 33,755 | 8,695,288.00 |
| XHELIL | SHEFKI | SHINI | 708 | LIZA | | MATI(ARYA)IRMA | 96.70 | 33,755 | 3,264,108.50 |
| | | | 709 | KRESHNIK | SHABAN | LUSHAJ | 51.70 | 33,755 | 1,745,133.50 |
| | | | 710 | NIMETE | | CELA | 43.80 | 33,755 | 1,478,469.00 |
| | | | 711 | GEZIM | | HYSA | | | |
| | | | 712 | LUAN | | MUMAJESI | | | |
| | | | 713 | SOKOL | | CELA | | | |
| | | | 714 | HATIXHE | | MUMAJESI | | | |
| | | | 715 | SILVANA | | KAIMI | | | |
| | | | 716 | JETMIRA | | HOXHA | | | |
| | | | 717 | ASTRIT | | KAIMI | | | |
| | | | 718 | FATMIR | | MUMAJESI | | | |
| | | | 719 | AISHE | | MUMAJESI | | | |
| BASHKIM | ASLLAN | GJONI | 720 | AGIM | | MUMAJESI | 180.50 | 33,755 | 6,092,777.50 |

Konferenca e komuniteteve iraniane në 42 qytete, ja çfarë u diskutua

# Patrick Kennedy, krah Majkos e Mediut: Populli i Iranit meriton ndryshime

## Maryam Rajavi: Organizatat që duhet të jenë në listën e terroristëve

Komunitetet iraniane nëEuropë, Amerikën e Veriut, Kanada dhe Australi mbajtën një konferencë të përbashkët në 42 qytete për të adresuar tendencën e rritur të shkeljeve të të drejtave njerëzore dhe eksportin e terrorizmit nga regjimi iranian, si dhe nevojën për një politikë vendimtare. Këto konferenca ishin të ndërlidhura në disa shtete njëkohësisht dhe anëtarët e MEK në Shqipëri iu bashkuan gjithashtu konferencës. Znj. Maryam Rajavi, e pranishme në këtë eveniment, suke iu referuar veprimtarive terroriste të regjimit iranian në 2018-ën, tha në fjalimin e saj: "Fakti që regjimi iranian e gjen zgjidhjen tek terrorizmi nuk është një reagim i përkohshëm apo taktik, por një rrugëdalje strategjike që ai e përdor për t'u ballafaquar me kryengritjet dhe me përmbysjen e vet". Ajo shtoi: "Sot, regjimi e përdor terrorizmin për t'u ballafaquar me kryengritjen e popullit iranian. Arrestimet dhe përjashtimet e diplomatëve terroristë të regjimit si dhe të terroristëve të lidhur me ambasadat e tij tregojnë se Këshilli Suprem Kombëtar i Sigurisë së regjimit, Trupat e Gardës Revolucionare (IRGC), Forca terroriste Quds, Ministria e Inteligjencës (MOIS), Ministria e Jashtme dhe ambasadat e regjimit janë të gjitha pjesë të rrjetit terrorist të këtij regjimi klerikal". Duke folur në takimin e muxhahedinëve në Shqipëri, znj. Maryam Rajavi tha: "IRGC, MOIS dhe makineria shtetërore e propagandës së regjimit duhet të vendosen në Listën amerikane të Organizatave të Huaja Terroriste si dhe në listën terroriste të Bashkimit Europian. Znj. Rajavi theksoi: "Regjimi nuk ka rrugëdalje dhe çdo zgjidhje që gjen, përfundon në dështim. Produkti i kësaj rruge qorre ka qenë rënia dramatike në statusin politik, ekonomik, shoqëror e ndërkombëtar të regjimit". Mes pjesëmarrësve e folësve në këtë konferencë ishin Patrick Kennedy, ish-anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve (SHBA); Pandeli Majko, ministër i Shtetit për Diasporën dhe ish-kryeministër (Shqipëri); Fatmir Mediu, kryetar i Partisë Republikane (Shqipëri); Ingrid Betancourt, ish-kandidate presidenciale (Kolumbi) si dhe personalitete të tjera politike, ligjore e fetare. Patrick Kennedy tha: "Në kundërshtim me propagandën e regjimit iranian, si demokratët, ashtu edhe republikanët në SHBA janë të bashkuar në mbështetjen ndaj një politike të rreptë mbi Iranin, për të qëndruar përkrah popullit iranian në dëshirën e tij për ndryshim dhe për të pasur një republikë demokratike të bazuar në zgjedhje të lira, ndarje të fesë nga shteti dhe barazi gjinore. Ky është konteksti brenda të cilit ne mbështesim Maryam Rajavi-n dhe deklaratën e saj me dhjetë pika për një Iran të lirë. Propaganda e regjimit kundër MEK, e cila jehon ndonjëherë në mediat perëndimore, është shenja më e dallueshme e frikës së regjimit nga popullariteti i MEK në Iran dhe roli i saj në protestat antiregjim. Është koha që edhe Europa të ngrihet kundër shtimit të terrorizmit të regjimit në Europë dhe veprimtarive të tij keqdashëse në rajon". Senatorja Ingrid Betancourt tha në fjalimin e saj, "Gjatë vitit të shkuar, regjimi iranian i ka shtuar veprimtaritë terroriste në Europë dhe njëkohësisht ka intensifikuar propagandën kundër MEK. Kjo gjë e tregon qartë frikën që regjimi ka nga MEK dhe nga roli i saj deçiziv në protestat e vazhdueshme antiregjim në Iran dhe dëshira e tyre për ndryshim regjimi. Është koha që qeveritë europiane të ndërmarrin një politikë të vendosur kundër regjimit dhe të mbajnë në mënyrë të qartë anën e popullit iranian. Së fundi, mediat e lira perëndimore duhet të qëndrojnë vigjilente për të mos përhapur propagandën e diktatorëve kundër opozitës demokratike". Në konferencë, përveç përfaqësuesve të shoqërive iraniane, një numër figurash politike e parlamentarësh folën gjithashtu në shtete të ndryshme.




**MARYAM RAJAVI**

"Fakti që regjimi iranian e gjen zgjidhjen tek terrorizmi nuk është një reagim i përkohshëm apo taktik, por një rrugëdalje strategjike që ai e përdor për t'u ballafaquar me kryengritjet dhe me përmbysjen e vet". Ajo shtoi: "Sot, regjimi e përdor terrorizmin për t'u ballafaquar me kryengritjen e popullit iranian".

**PATRICK KENNEDY**

"Në kundërshtim me propagandën e regjimit iranian, si demokratët, ashtu edhe republikanët në SHBA janë të bashkuar në mbështetjen ndaj një politike të rreptë mbi Iranin, për të qëndruar përkrah popullit iranian në dëshirën e tij për ndryshim dhe për të pasur një republikë demokratike të bazuar në zgjedhje të lira, ndarje të fesë nga shteti dhe barazi gjinore.

## Poloni, arrihet marrëveshje për ndryshimet klimatike



Ekipi negociator në Poloni gjatë samitit COP24 në Kombet e Bashkuara, ku u diskutua për ndryshimet klimatike, ka siguruar marrëveshjen për marrjen e disa masave që do të bënin efektiv Paktin e Parisit për Klimën më 2020. Delegatët besojnë se vendimet e reja do të sigurojnë premtimet e shteteve për të ndalur përdorimin e karbonit. Marrëveshja duhet të sigurojë parimet e Paktit të Klimës për limitimin e temperaturës globale, që nuk duhet të shkojë më poshtë se 2 gradë celsius. "Vendosja e të gjitha marrëveshjeve në programin e punës është përgjegjësi e madhe", tha kryesuesi i bisedimeve, Michal Kurtyka. Marrëveshja e samitit e arritur nga 196 shtete nënvizon rregullat e secilit shtet që do të qeverisë mënyrën se si do të ndalojnë përdorimin e karbonit, të sigurojnë të ardhura për vendet e varfra dhe të sigurojë se të gjithë po bëjnë atë që duhet.

**NJOFTIM**

Në datë **19.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Irisa Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertese" me sip. Trualli 220 m2 dhe sip.ndertese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volum 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur ne Lagjia "Jani Vruho", Berat.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,280,000 (tre milion e dyqind e tetedhjete mije) lekë.**

**NJOFTIM**

Në datë **18.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Irisa Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertesë" me sip. Trualli 300 m2 dhe sip.ndërtese 120 m2, me nr.pasurie 522/10/1, volum 6, faqe 2, zonë kadastrale 1167, ndodhur ne Bërxull, Tiranë.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,940,248 (tre milion e nëntëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë.**

**SHKURT**



### Aksident ajror në Portugali, vdesin katër persona

Një helikopter mjekësor është përplasur në një zonë malore afër Portos në Portugali, duke lënë të vdekur dy pilotë, një doktor dhe një punonjëse të shëndetësisë, njoftojnë autoritetet. Një operacion kërkim-shpëtimi nisi të shtunën pasdite kur helikopteri u zhduk pasi kishte zbritur në Porto për të lënë një pacient që kishte problem me zemër. Autoritetet shtuan se rreth orës 1:30 të mëngjesit u gjetën trupat e pajetë të viktimave. Helikopteri ishte duke u kthyer në bazë kur u përplas si pasojë e motit të keq.



### Ministria e Jashtme turke: Do vazhdojnë sulmet ndaj kurdëve në Irak

Turqia do të vazhdojë me sulmet ndaj luftëtarëve kurdë në veri të Irakut, deklaruan nga Ministria e Jashtme turke, një ditë pasi Bagdadi zyrtar tha se Turqia ka shkelur sovranitetin e shtetit. Ushtria turke tha të premten se ka vrarë teta militantë kurdë. Turqia rregullisht sulmon bazat e Partisë së Punëtorëve të Kurdëve, PKK dhe malet përreth rajonit verior të Irakut. Presidenti turk, Reçep Tayyip Erdogan, ka kërcënuar me nisjen e ofensivës në veri të Irakut më herët këtë vit. Këtë javë ai tha se do të zhvillojë një operacion edhe për kurdët në kufi me Sirinë. "Aktivitetet e PKK-së në territorin e Irakut dhe të Sirisë janë bërë çështje e rëndë për sigurinë kombëtare në Turqi", - tha ministri i Jashtëm, Hami Aksoy. "Këto operacione në luftën kundër terrorizmit do të vazhdojnë deri sa këto organizata të shuhen nga këto territore", shtoi ai. PKK shquhet si organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

GAZETA SHQIPTARE
Life pages
Suplement
E hënë 17 Dhjetor 2018 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Përdorni vajin e dafinës kundër gripit

# MEGINA LAÇKA:

- Dermatologia: Vetëm përdorimi i kremit hidratant nuk është i mjaftueshëm



## Mënyrat e mbrojtjes së lëkurës gjatë dimrit

"Kujdes edhe me dietën ushqimore, sa më shumë ujë"

## KESHILLA



Mënyrat e trajtimit të skoliozës te fëmijët dhe adoleshentët

## Kura çudibërëse ndaj reumatizmës e mbipeshës

Dermatologia: Vetëm përdorimi i kremit hidratant nuk është i mjaftueshëm

# MEGINA LAÇKA: Mënyrat e mbrojtjes së lëkurës gjatë dimrit

## "Kujdes edhe me dietën ushqimore, sa më shumë ujë"

Voltiza Duro



Megina Laçka



Në stinën e dimrit, ulja e temperaturave ndikon në prishjen e strukturës së lëkurës. Për të evituar problemet me lëkurën duhet të ndryshojë edhe mënyra e përkujdesjes për të, veçanërisht për fytyrën. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja dermatologe, njëkohësisht edhe kimiste, Megina Laçka, tregon se cilat janë mënyrat më të mira për mbrojtjen e lëkurës gjatë dimrit. Ajo thekson se gjithmonë duhet përdorur një krem hidratant dhe këshillon që duhet të nisë edhe përdorimi i tonikëve apo lateve të ndryshme, serumit, kremi për zonën e syve dhe kremi për fytyrën ditë dhe natë. Ajo këshillon që të konsumohet sa më shumë ujë dhe lëngje, si edhe ushqime të lehta me përmbajtje të lartë hidrike si frutat dhe perimet.

**Si ndikon ulja e temperaturave në lëkurën tonë?**

Lëkura është organi ynë më i madh, i cili duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me agjentët atmosferikë, është shumë delikat. Ndryshimi i temperaturave apo i stinëve sjell probleme të ndryshme për të. Stina e dimrit sjell uljen e temperaturave dhe kjo ndikon në prishjen e strukturës së lëkurës. Kjo të do të thotë se dhe regjimi ynë i të kujdesurit për të duhet të ndryshojë.

**Çfarë ndodh specifikisht me të?**

Gjatë dimrit lëkura dehidratohet, ashpërsohet dhe për rrjedhojë merr një pamje të lodhur dhe jo vitale. Ne mund të përdorim shumë produkte kozmetike, por është e rëndësishme të zgjedhim produkte që do i krijojnë lëkurës butësi dhe shkëlqim.

**Si këshillohet larja e fytyrës në stinën e ftohtë të dimrit?**

Një nga këshillat kryesore që unë do të jepja është kujdesi gjatë larjes së fytyrës. Asnjëherë lëkura nuk duhet të lahet me ujë të nxehtë ose të ftohtë, por gjithmonë me ujë të ngrohtë, për arsye se nuk duhet të largojmë shumë molekula yndyre ose sebumi prej lëkurës, për shkak të funksioneve të tyre.

**A duhet të përdoret kremi hidratant dhe si duhet zgjedhur?**

Gjithmonë duhet të përdorim një hidratant për lëkurën dhe duhet të kemi një kujdes ose regjim të plotë të saj duke nisur me serumin dhe kremin. Duhet të tregojmë shumë kujdes kur zgjedhim produktet, pasi duhet të përdorim ato që i përshtaten më mirë fototipit dhe profilit të lëkurës sonë. Duhet ta eksfoliojmë lëkurën vazhdimisht dhe ky është një hap shumë i rëndësishëm, pasi shërben për të larguar qelizat e vdekura nga sipërfaqja e lëkurës dhe kështu i krijon asaj butësi. E rëndësishme është gjithashtu që kujdesi i lëkurës të jetë i plotë, duke i siguruar asaj një mbrojtje sa më të plotë si gjatë ditës, ashtu edhe gjatë natës.

**A është i mjaftueshëm vetëm përdorimi i kremit hidratant?**

Kur them duhet një regjim i plotë e kam fjalën jo vetëm për përdorimin e një kremi në mëngjes ose në darkë. Gjatë kësaj periudhe, ashtu siç u shpreha edhe më lart, lëkura është e dehidratuar prandaj regjimi duhet të nisë me përdorimin e tonikëve apo lateve të ndryshme, serumit, me kremin për zonën e syve dhe kremin për fytyrën ditë dhe natë. Dua të theksoj që duhet të tregoni kujdes kur zgjidhni kremin e fytyrës, pasi përpos përbërësve që duhet t'i verifikoni, sigurohuni që ai përmban filtër mbrojtës ndaj rrezatimeve UVA-UVB, pasi dhe në stinën e dimrit rrezet janë të depërtueshme në lëkurë. 1 ose 2 herë në javë duhet ta eksfolojmë me maska me argjila të ndryshme, në varësi të tipit të lëkurës ose me skrabe të ndryshme.



**Cilat klasifikohen si lëkurat më delikate dhe si duhet vepruar për trajtimin e tyre gjatë dimrit?**

Të ndalem pak te problemet e lëkurës. Gjatë stinës së dimrit, të gjitha lëkurat kanë nevojë për mbrojtje dhe ushqyerje. Por lëkurat më delikate, që janë më të prekshme nga këto ndryshime janë ato që kanë problem si dermatitis apo rosacea. Këto lëkura me këto probleme kërkojnë një kujdes të veçantë dhe duke qenë se janë problem autoimmune, kërkojnë dhe një kujdes në mënyrën e të ushqyerit dhe në stilin e jetesës.

**Çfarë rekomandoni lidhur me dietën ushqimore?**

Gjatë kësaj periudhe organizmi ynë ka nevojë të konsumojë sa më shumë ujë dhe lëngje, si edhe ushqime të lehta me përmbajtje të lartë hidrike si frutat dhe perimet.

**Cilat janë disa nga këshillat tuaja për mbrojtjen e lëkurës së duarve dhe trupit?**

Jo vetëm fytyra ka nevojë për mbrojtje dhe rigjenerim, por edhe buzët apo duart si dhe trupi apo flokët. 1 ose 2 herë në javë mund të realizoni maska të ndryshme në kushte shtëpie për fytyrën, trupin apo flokët të cilat shërbejnë për të ushqyer, pastruar dhe rigjeneruar në thellësi lëkurën. Ajo që unë u këshilloj gjithmonë pacientëve të mi është kujdesi në mënyrë natyrale si në ushqyerje, ashtu edhe në mirëqenien e lëkurës për të qenë sa më të shëndetshëm brenda dhe jashtë, sepse një organizëm i shëndetshëm pasqyrohet në një lëkurë të shëndetshme.



Voltiza Duro

Vaji esencial i dafinës është një ndër produktet më të përdorshme sidomos në periudhën e dimrit, pasi ndihmon në hapjen e rrugëve të frymëmarrjes tek fëmijët dhe të rriturit. Është shumë praktik për t'u përdorur dhe shumë efektiv. Ky vaj ndikon menjëherë në zhbllokimin e sinuseve. Dafina është ndër bimët më të përdorura që në lashtësi. Gjethet e dafinës përveç përdorimit si bimë medicinale, përdoren në gatime për aromatizimin e gjellës apo peshkut. Dafina është bimë që qëndron jeshile gjatë gjithë vitit. Dy gjinitë e ndryshme të bimës ndodhen në bimë të ndryshme, pra janë të ndara në bimë mashkullore dhe bimë femërore. Bima rritet deri në lartësi 20 metra e kur mbillet kërkon disa vite për të arritur pjekurinë e duhur për të dhënë një produkt të konsiderueshëm. 3-4 vitet e para bima qëndron e vogël dhe vetëm i priten majat që të mund të rritet më shumë, pastaj fillon të marrë zhvillim të mëtejshëm. Në Shqipëri rritet kryesisht në vendet malore, toka me gurë të thatë dhe vende me diell.

Vetitë e dafinës në organizëm:

Vaji i dafinës ka shumë efekte pozitive në organizëm. Dafina ka veti antibakteriale, qetësuese, antibiotike dhe tonike në trupin e njeriut. Përdoret për sëmundje të ndryshme si: astma, kolla, gripi, sinoziti, vështirësi në frymëmarrje, laringiti, në rastet e ikjes së zërit etj. Ka përdorime të ndryshme që janë shumë praktike në jetën e përditshme e vaji i dafinës mund të merret me pika direkt në gojë. Nëse e keni problem shijen e fortë mund të hollohet në çdo ushqim, sidomos lëng portokalli apo qumësht. Mund të përdoret edhe në aerosole, apo aromatizuesit e dhomës. Në këtë rast ndihmon që të ngordhin mikrobet në ajër, freskon ajrin e dhomës dhe ndihmon në frymëmarrje të lehtë të gjithë pjesëtarëve të familjes. Vetitë e forta antibakteriale të dafinës bëjnë që të ndërpritet zhvillimi dhe rritja e baktereve në organizëm. Ndihmon në largimin e infeksioneve në sinuse, në gojë dhe në fyt. Krijon një mjedis në organizëm që ndalon rritjen e viruseve të gripit, prandaj parandalon gripin. Gjithashtu ka veti antibiotike dhe nëse keni grip e filloni të përdorni vajin e dafinës, vetëm pas 2 ditësh përdorimi do të ndiheni të rigjallëruar dhe do të keni përmirësim më shumë se 50%. Vaji i dafinës ka edhe veti sedative, prandaj kur keni kollë, astmë apo dhimbje koke nga sinoziti këshillohet të përdoret ky vaj, pasi qetëson dhimbjet e kokës dhe fyti, madje ndihmon në largimin e etheve dhe temperaturës së lartë. Mund të përdoret për masazh i holluar në vaj tjetër, pasi ndihmon në uljen e dhimbjeve të muskujve dhe kockave, sidomos dhimbjet reumatizmale.

Vaji i dafinës është tonifikues i gjithë organizmit dhe ndihmon në absorbimin e vitaminave dhe mineraleve në organizëm, largon kripën e tepërt dhe rregullon jashtëqitjen. Një tjetër veti i këtij vaji është ndihma që jep në tretjen e ushqimit dhe rregullimin e metabolizmit. Gjithashtu, jep efekt në sekretimin e enzimave tretëse të mëlçisë në stomak dhe ndihmon në balancimin e pH në stomak. Vaji i dafinës zbardh dhëmbët, mund të hidhen dy pika në gojë në mëngjes dhe pasi njomet furça me ujë të fërkohen dhëmbët me ato pika. Pas një jave përdorim do të dalloni zbardhje të dhëmbëve dhe shëndoshje të mishit të tyre. Dafina ka veti antibakteriale dhe kështu ndihmon në ngordhjen e baktereve që ndodhen në gojë midis dhëmbëve që shkaktojnë erën e keqe të gojës, dhe skuqjen e mishrave të dhëmbëve. Mund të përdoret në verë i përzier me një vaj tjetër për të lyer trupin, ose mund të hidhet me sprajt nëpër dhomë, pasi ndihmon në largimin e mushkonjave dhe insekteve nga aroma e fortë që ka vaji.

## Mjeku popullor: Ndihmon në tretjen e ushqimit dhe rregullimin e metabolizmit

# YLLI MERJA:

# Përdorni vajin e dafinës kundër gripit

## *"Lufton edhe astmën, sinozitin dhe laringitin"*



Ylli Merja

**Përbërësit kimikë në vajin e dafinës:**

Bima e dafinës përmban vaj esencial, flavonoide, tanine, acide fenolike, cineole, linanole etj. Për shkak të tanineve që i japin hidhërimin në shije dhe kanë efekte anësore në organizëm, ky vaj duhet përdorur i holluar siç është përshkruar më lart. Përmban eukaliptol, eugenol, terpineol të cilat i japin vetitë antibakteriale bimës dhe që ndihmojnë në luftën ndaj gripit, apo infeksioneve të ndryshme në lëkurë apo organizëm.




**Përdorimi:**

Vaji i dafinës përdoret si një përbërës aromatizues në industrinë ushqimore dhe si një përbërës aromatik në kozmetikë dhe parfumeri. Mund ta përdorni në gatime, nëse dëshironi një aromë të fortë të dafinës dhe mund të shtoni 2-3 pika vaj dafine në një tenxhere me ushqim për 5 persona. Vaji i dafinës duhet të përdoret i holluar, pasi është shumë i përqendruar dhe mund të shkaktojë efekte anësore, prandaj duhet holluar 60% vaj dafine me 40% vaj ulliri. Mund të përdoret për të larguar kollën, të ftohtin, gripin nga fëmijët dhe të rriturit. Për fëmijët: hidhen 2 herë nga 1 pikë direkt në gojë, apo e tretur në qumësht pas ushqimit. Të rriturit: Përdoret 2 herë nga 3 pika pas ushqimit.






# Mënyrat e trajtimit të skoliozës te fëmijët dhe adoleshentët

Skoliozë quhet deformimi që vjen si rrjedhojë e një kurbimi anësor të një segmenti të shtyllës kurrizore ndaj boshtit gjatësor të saj, gjë që e bë atë të duket në formën "S" ose "C" që normalisht duhet të jetë e drejtë e të ketë formën e "I". Skolioza mund t'u shkaktojë vertebrave rrotullim, gjë që shkakton që njëra shpatull apo kërdhokull (këllq) të jetë më lart se tjetra. Termi "idiopathic" do të thotë që nuk i dihet shkaku nga vjen kjo sëmundje. Pra, skolioza përfaqëson të shtrembëruarit anësor dhe rrotullues të shtyllës kurrizore. Kemi të bëjmë me një dëmtim 3- dimensional. Nganjëherë rrotullimi përcakton edhe një deformim të kafazit të kraharorit dhe të organeve që përmbahen në të (zemra, mushkëritë dhe diafragma).

*KLASIFIKIMI I SKOLIZËS:*

*KLASIFIKIMI SIPAS MOSHËS:*

- Skolioza adoleshente idiopatike ndodh pas moshës 10 vjeç. Ajo është lloji më i zakonshëm.
- Skolioza juvenile ndodh në fëmijët midis moshës 3 dhe 10 vjeç. Kjo nuk është e zakonshme.
- Skolioza infantile( fëminore) ndodh në fëmijët më të vegjël se 3 vjeç. Kjo mund të rezultojë nga anomali të lindura të vertebrave, sindroma të ndryshme, çrregullime neurologjike, ose për arsye të panjohura (idiopatike).

*KLASIFIKIMI SIPAS SHKAKUT:*

- 80% e tyre janë me origjinë idiopatike (pa një shkak të njohur).
- Skolioza kongenitale, që e marrin origjinën nga defekte të organogjenezës gjatë periudhës embrionale.
- Skolioza neuromuskulare (nga poliomieliti, osteodistrofia etj.).

Skolioza është rreth 7 herë më e shpeshtë tek femrat se tek meshkujt dhe shfaqet më së shumti në moshat nga 3 në 10 vjeç. 5% e popullsisë botërore është e prekur, prej të cilëve 81% nuk dihen shkaqet, 15% e lindur dhe rreth 10% nervoremuskulore. Kurba të vogla kurrizore ndodhin me frekuencë të ngjashme në djem dhe vajza, por vajzat kanë më shumë të ngjarë që të kenë një kurbë progresive të madhe skoliotike që do të kërkojë trajtim.

*SIMPTOMAT*

Skolioza zakonisht nuk shkakton asnjë dhimbje, mosfunksionim neurologjik, ose probleme të frymëmarrjes. Shqetësimi mbi pamjen kozmetike të shpinës shpesh është shqetësimi kryesor i pacientit dhe prindërit. Pra, është një sëmundje e ngadaltë dhe progresive, përgjithësisht asimptomatike. Shpesh janë prindërit ose pediatri të parët që vënë re që diçka ka ndryshuar në qëndrimin e fëmijës. Në raste të rralla mund të shfaqen shqetësime në kolonën vertebrale apo lodhje muskulore pas sforcimit fizik. Përgjithësisht fëmija është i qetë, fle mirë dhe vazhdon të kryejë normalisht veprimtaritë e tij të përditshme.

*DIAGNOZA*

Mjeku do t'i kërkojë fëmijës tuaj për të përkulet përpara, gjë e cila do të tregojë ndonjë deformim. Kjo quhet "Testi i përkuljes përpara të Adamit". Mjeku gjithashtu do të kontrollojë për ndonjë mospërputhjet në gjatësi të gjymtyrëve, gjetjet abnormale neurologjike, apo shkaqe të tjera të mundshme. Shumë shkolla rregullisht kryejnë depistim të skoliozës tek nxënësit. Këto depistime zakonisht bëhen gjatë viteve të shkollës së mesme dhe 9 -vjeçare. Fëmija juaj mund të marrë një rekomandim për skoliozë nga një mjek bazuar në rezultatet e depistimit të shkollës. Diagnoza diferenciale duhet bërë ndërmjet skoliozës anatomike me rrotullim, dhe të ashtuquajturës "skoliozë funksionale", e cila është një patologji që trajtohet shumë më thjesht, meqë në bazën e saj nuk ka defektet kockore. Skolioza konfirmohet nga një x-ray të shpinës. Mjeku juaj do të masë shkallën e kurbës, siç tregohet në x-ray.




*TRAJTIMI*

Lloji i trajtimit të nevojshëm varet nga lloji dhe shkalla e kurbës, mosha e fëmijës dhe numri i viteve të rritjes së mbetur deri sa fëmija të arrijë pjekurinë skeletike. Duke pasur parasysh ecurinë e ngadaltë të sëmundjes, këshillohet të kryhet, rreth moshës 5-6 vjeç, një vizitë kontrolli e tipit parandalues. Më pas do të jetë ortopedi ai që do të vendosë nëse duhen kryer ekzaminime të mëtejshme. Kjo sëmundje duhet diagnostikuar shpejt (maksimumi brenda moshës 13 vjeç). Pas kësaj moshe bëhet e vështirë arritja e rezultateve të mira, sepse kërcet që quhen "kërce të rritjes" fillojnë gradualisht të mbyllen, duke e bërë strukturën kockore që duam të korrigjojmë më pak të "modelueshme". Pra, kjo është një patologji e cila duhet trajtuar brenda moshës së adoleshencës, me mjekime fizioterapeutike, korrigjuese apo kirurgjikale, në varësi të rastit. Trajtimi jokirurgjikal është i përshtatshëm kur kurba është e butë ose nëse fëmija është afër maturimit skeletik. Mjeku mund t'ju kërkojë rikontrolle të herëpashershme për të parë kurbën në se është progresive apo është duke u përkeqësuar. Mund t'ju kërkohet që të vizitoheni çdo 3-6 muaj për riekzaminim. Shumica e rasteve të skoliozës së identifikuar nga skrinimi në shkollë, bëjnë pjesë në këtë kategori. Qëllimi i vendosjes së korseve është për të parandaluar përkeqësimin e skoliozës. Korsetë mund të jenë efektive nëse fëmija është ende në rritje. Ortopedi juaj do t'ju rekomandojë një korse dhe do t'ju tregojnë se sa kohë duhet të mbani veshur çdo ditë. Veshja e një korseje me nuk ndikon në pjesëmarrje në aktivitetet sportive.

*TRAJTIMI KIRURGJIKAL*

Nëse kurba është më shumë se 45° dhe fëmija është ende në rritje, mjeku mund të rekomandojë kirurgji-operacion. Nëse pacienti ka arritur pjekurinë skeletike, operacioni mund të jetë ende i rekomanduar për skoliozat që tejkalojnë 50° në 5°. Implantet që përdoren përbëhen nga shufra, grepa, vida dhe/ose tela, të cilat shërbejnë për të drejtuar shpinën. Merret graft kockor nga banka e kockave nga kockat e legenit të vetë fëmijës që përdoren për të rritur konsolidimin dhe shërimin e shtyllës kurrizore. Pas operacionit, pacientët zakonisht ecin nga dita e dytë, pa pasur nevojë për një korse, dalin nga spitali brenda 1 jave dhe shpejt mund të rifillojë aktivitetet e tyre të përditshme.

# Këshilla



# Kura çudibërëse ndaj reumatizmës e mbipeshës

Përdorimi i rregullt i hudhrës çdo ditë ndihmon në trajtimin e shumë sëmundjeve. Kura e mëposhtme konsiderohet shumë efikase kundër reumatizmës, aterosklerozës, problemeve me shikimin, mbipeshës, sinozitit e të tjerë. Mënyra e përgatitjes së kurës është tejet e lehtë. Përbërësit që iu nevojiten janë: 250 ml alkol i pijshëm (40 gradë) ose raki dhe 350 gramë hudhër. Qërojini hudhrat dhe hidhini në një kavanoz. Shtoni alkoolin dhe mbylleni kavanozin me kapak. Mbajeni në frigorifer për 10 ditë. Pas 10 ditësh filtrojeni lëngun dhe mbajeni në frigorifer për 3 ditë të tjera. Për përdorimin e tretësirës duhet të përdorni një pikatore. Ditën e parë, përpara se të hani mëngjes duhet të merrni një pikë, më pas dy pika përpara drekës dhe tre pika përpara darkës. Ditën e dytë, duhet të merrni 4 pika përpara mëngjesit, 5 përpara drekës dhe 3 përpara darkës. Ditën e tretë duhet të konsumoni 7 pika përpara vaktit të parë, 8 pika përpara drekës dhe 9 pika përpara darkës. Në ditën e katërt duhet të merrni 10 pika përpara mëngjesit, 11 përpara drekës dhe 12 përpara darkës. Ditën e pestë duhet ta rrisni dozën në 13 pika përpara mëngjesit, 14 pika përpara drekës dhe 15 pika përpara darkës. Në ditën e 6-të duhet të merrni 15 pika përpara mëngjesit, 14 pika përpara drekës dhe 15 pika përpara darkës. Në ditën e 7-të duhet të merrni 12 pika përpara mëngjesit, 11 pika përpara drekës dhe 10 pika përpara darkës. Në ditën e tetë duhet të merrni 9 pika përpara mëngjesit, po aq përpara drekës dhe 7 pika përpara darkës. Në ditën e nëntë duhet të merrni 6 pika përpara mëngjesit, 5 pika përpara drekës dhe 4 pika përpara darkës. Në ditën e fundit merrni tri pika përpara mëngjesit, 2 pika përpara drekës dhe një pikë nga tretësira përpara darkës.





# Mandarinat, ekuilibruese të tensionit të gjakut në organizëm

Mandarina është fruti më i pëlqyer dhe kërkuar në treg gjatë stinës në vijim. Antioksidantët që gjenden tek mandarinat, ulin kolesterolin e keq dhe largojnë radikalet e lira në organizëm. Shumë të pasura me fibra, mandarinat stimulojnë rënien në peshë. Sipas studimeve nëse konsumoni mandarina rregullisht, tensioni juaj i gjakut do të jetë më i ekuilibruar. Vitamina C tek ky frut plot shije lufton të ftohtin e gripin dhe forcon imunitetin. Konsumi i mandarinave ose i ushqimeve të tjera të pasura me vitaminë C, ndërsa keni ngrënë produkte me përmbajtje të lartë hekuri, rrit mjaft thithjen e këtij minerali nga organizmi juaj. Përdorimi i mandarinave është një nga metodat më të mëdha natyrore për të mbrojtur zemrën tuaj nga dëmtimi dhe për të minimizuar sasitë e kolesterolit brenda gjakut tuaj. Mandarinat si agrume shmangin dëmtimin oksidues brenda arterieve tuaja dhe riparon elasticitetin e enëve të gjakut. Mandarinat mund të ulin rrezikun për të zhvilluar kancer të mëlçisë. Në të vërtetë, studiuesit amerikanë kanë zbuluar se njerëzit të cilët kanë hepatit kronik mund të ulin zhvillimin e kancerit të mëlçisë duke pirë lëng nga mandarinat e freskëta. Në studimin njëvjeçar kishin marrë pjesë rreth 30 pjesëmarrës të cilët kishin pasur hepatit viral dhe të cilët kishin konsumuar lëng të mandarinës në baza ditore. Në fund të studimit ata nuk kanë pasur kurrfarë shenje të kancerit të mëlçisë. Për dallim prej tyre, në mesin e 45 pjesëmarrësve me të njëjtin problem dhe të cilët nuk kanë konsumuar pije të mandarinës, shkalla e zhvillimit të kancerit të mëlçisë ka qenë 8.9 për qind. Mandarinat mund të ofrojnë deri në 80 për qind të nevojave ditore për vitaminë C, e cila ndihmon në forcimin e imunitetit.

KONCERTI





**Tek "arTurbina", detajet, ja kush do të performojë**

# Xhimi Lazri sjell sot koncertin-antologji, perlat që do të dëgjoni

## *Kantautori Pirro Çako, i ftuar nderi*






Sot, më 17 dhjetor 2018 në sallën "arTurbina" në Tiranë, Xhimi Lazri vjen ndryshe me Koncertin-Antologji. Me mënyrën spontane e informuese të prezantimit, kjo shfaqe do i ngjajë më shumë një "Cabare-show", e cila mund të quhet një risi në Shqipëri. Xhimi Lazri, para çdo kënge do e fusë publikun në brendinë e saj, duke e lidhur emocionin muzikor me atë konceptual. Në koncert do të interpretohen këngë nga fondi i artë i muzikës shqiptare, këngë të reja, si edhe këngë nga repertori më i zgjedhur ndërkombëtar. Pirro Çako, kantautori i dashur për të gjithë është i ftuari i nderit në Antologjinë e Muzikës, së organizuar nga Xhimi Lazri. "Falënderoj Bashkinë e Tiranës për mbështetjen e kësaj veprimtarie dhe dua të theksoj edhe qasjen bashkëkohore të marrëdhënieve të Bashkisë Tiranës me artistët në realizimin e projekteve të ndryshme, në stimulimin që kjo mbështetje nga ana e bashkisë i ka dhënë jetës muzikore e kulturore në kryeqytet", thotë për "Gazeta Shqiptare" organizatori. Xhimi Lazri është kompozitor me kontribute në fushën e muzikës serioze dhe prej 20 vjetësh i pranishëm në jetën muzikore 'live' në Shqipëri, me vepra të ekzekutuara në Itali, por në këtë koncert ai do të intepretojë këngë të riaktualizuara të kompozitorëve si Tish Daija, Simon Gjoni, por edhe Edith Piaf, Charles Aznavour, Adriano Çelentano, Rikardo Koçante. Koncerti do të shoqërohet nga "All in band": një formacion muzikore orkestral krijuar në vitin 2015, por me një CM tashmë solide: Rajkad Bardhi (Trumpet), Eneo Gjoka (saxophone tenor), Ridvan Shaqia, Ronald Gjuri, Mateos Gjipi, Besina Herri, Kejdi Barbullushi. Ky formacion muzikor ka qenë 2 herë konkurrues në festivalin "Kënga Magjike", ka dhënë suport muzikor në koncertet e "Dua Lipa", si edhe "John Newman", ka konkurruar në "Jazz live-festival", Tiranë, Festival jazz "Maratona Swing"... Gjatë koncertit do të bëhet edhe promovimi i një këngëtareje të re. Kjo shfaqje padyshim do të plotësojë hapësirën boshe në jetën kulturore të Tiranës dhe të Shqipërisë, me repertorin e mrekullueshëm që do të sjellë Xhimi Lazri me bandën e të ftuarit e tij.



### Hashim Thaçi: Themelimi i ushtrisë, proces i pakthyeshëm

# Stoltenberg: Ushtria në kundërshtim me NATO-s, ndikim në integrimin e Kosovës


Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg

Kreu i Kosovës, Hashim Thaçi ka deklaruar se themelimi i ushtrisë së Kosovës, pavarësisht diskutimeve që pritet të ndodhin në Këshillin e Sigurimit, është një proces i pakthyeshëm dhe vetëm do të fuqizohet. Sipas tij, nëse Serbia është shqetësuar për themelin e ushtrisë kosovare, serbët e Kosovës ndihen të sigurt. Ai foli edhe për rezolutën për dialogun me Serbinë, e cila është votuar dje në Kuvend, duke thënë se ishte një lajm i përgjegjësisë kombëtare dhe kushtetuese. "Kosova ka bërë një sukses të jashtëzakonshëm dy ditët e fundit, duke themeluar ushtrinë dhe duke ndërtuar konsensusin e gjerë politik dhe civil për dialog Kosovë-Serbi", tha ai. Kosova krijoi forcën e saj të armatosur më 14 dhjetor 2018. Ishte përkrahja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar që çoi në përfundimin se Kosova ka të drejtë të krijojë ushtrinë e saj. Por, NATO ka kërkuar në vazhdimësi që Kosova duhet ta formojë ushtrinë me ndryshime kushtetuese. "Ky hap vjen në një kohë të gabuar, është në kundërshtim me rekomandimet e shumë aleatëve të NATO-s dhe mund të ketë pasoja serioze për integrimin euroatlantik të Kosovës", tha sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg. Ndërsa, ditën e shtunë, kur Kosova zyrtarizoi ushtrinë, erdhi reagimi i NATO-s. Aty thuhej që ky vendim u bë pavarësisht shqetësimeve të NATO-s si dhe sipas tij, vendimi i sotëm nuk duhet të rrisë tensionet në rajon. "Sot, institucionet në Kosovë kanë njoftuar miratimin e tri ligjeve, që iniciojnë procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Më vjen keq që ky vendim është marrë, pavarësisht shqetësimeve të shprehura nga NATO. Ndërkohë që transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës është në parim një çështje e vendos Kosova, por ne kemi bërë të qartë se ky veprim është i gabuar", pohoi ai.

> **HASHIM THAÇI**
> "Kosova ka bërë një sukses të jashtëzakonshëm dy ditët e fundit, duke themeluar ushtrinë dhe duke ndërtuar konsensusin e gjerë politik dhe civil për dialog Kosovë-Serbi", tha ai. Kosova krijoi forcën e saj të armatosur më 14 dhjetor 2018. Ishte përkrahja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar që çoi në përfundimin se Kosova ka të drejtë të krijojë ushtrinë e saj.

### Bashkimi Europian: UNMIK të zëvendësohet me emrin Kosova në CEFTA

# Haradinaj, Mogherinit: Nuk e heqim taksën ndaj Serbisë

## *Tarifa 100%, BE i ofron kompromis Kosovës*

> **KONFIMIMI**
> Pas raportimit të mediave se Mogherini bashkë me Komisioneren për tregti, Malmstrom dhe Komisionerin Hahn iu drejtuan Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt, për zgjidhjen e problemit të tarifave ndaj Serbisë, shefi i stafit të Haradinajt, Avni Arifi ka konfirmuar se qeveria e ka pranuar letrën në fjalë për të cilën kryeministri do të kthejë përgjigje sot.


Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

> **AVNI ARIFI**
> "Letra nuk përmban asnjë rresht me ndonjë qëndrim që nuk është i njohur për qytetarët e Kosovës. Të gjitha qëndrimet e qeverisë janë të njohura për qytetarët", tha shefi i stafit të Haradinajt, Avni Arifi.

Pas kërkesës së Federica Mogherinit, e clia ka ofruar që në këmbim të heqjes së taksës ndaj Serbisë, që emërtimi UNMIK të zëvendësohet me Kosovo, qeveria e Kosovës reagoi duke thënë se nuk do të bëjë asnjë kompromis me BE-në. Një përgjigje me shkrim Mogherinit pritet t'i dërgohet ditën e sotme, përmbajtja e së cilës qartëson se Ramush Haradinaj nuk do të ketë asnjë qëndrim ndryshe nga ato që tashmë i njohin të gjithë qytetarët e Kosovës. Pas raportimit të mediave se Mogherini bashkë më Komisioneren për tregti, Malmstrom dhe Komisionerin Hahn iu drejtuan Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt, për zgjidhjen e problemit të tarifave ndaj Serbisë, shefi i stafit të Haradinajt, Avni Arifi ka konfirmuar se qeveria e ka pranuar letrën në fjalë për të cilën kryeministri do të kthejë përgjigje sot. "Letra nuk përmban asnjë rresht me ndonjë qëndrim që nuk është i njohur për qytetarët e Kosovës. Të gjitha qëndrimet e qeverisë janë të njohura për qytetarët", tha Arifi. Në bazë të kësaj deklarate, nënkuptohet se qeveria do t'i thotë 'jo' ofertës së BE-së. Pra, sipas të gjitha gjasave, Mogherini bashkë me komisionerët tjerë të BE-së do të marrë përgjigje negative. Pas dështimit në INTERPOL, për të cilin Serbia loboi maksimalisht kundër Kosovës, qeveria mori vendim për taksë 100% ndaj produkteve serbe dhe atyre boshnjake. Humbjet që i shkaktohen Serbisë dhe Bosnja e Hercegovinës karshi taksës së vendosur për produktet e këtyre shteteve nga Republika e Kosovës po u kushtojnë këtyre shteteve me miliarda euro të humbura. Përveç kësaj, qeveria "Haradinaj" ka paralajmëruar edhe masa të tjera të reciprocitetit. Nga ana tjetër, kujtojmë se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Mogherini; Komisionerja për tregti Malmstrom dhe Komisioneri Hahn në një letër të përbashkët drejtuar Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt ofrojnë opsion për zgjidhjen e problemit të tarifave ndaj Serbisë. BE ofron mes tjerash që emërimi "UNMIK" në CEFTA të zëvendësohet me "Kosova". Por kërkojnë që si shenjë e vullnetit të mirë, para 17 dhjetorit, kur në Bruksel zhvillohet takimi i Këshillit të MSA-së, Kosova përkohësisht të pezullojë zbatimin e vendimit për tarifën ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Këta pjesëtarë të Komisionit Evropian, letrën Kryeministrit të Kosovës ia kanë shkruar edhe duke adresuar disa shqetësime që Haradinaj ua ka shprehur në letrën që ai e kishte dërguar më parë, kur kishte sqaruar arsyet pse Kosova kishte vendosur këto masa. "Ne kemi marrë në dijeni po ashtu edhe listën e rasteve të praktikës tregtare nga ana e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, që sipas këndvështrimit të Kosovës, paraqesin barriera në zbatimin korrekt të aranzhimeve të CEFTA-s dhe krijojnë problem domethënëse në terren për veprimet ekonomike dhe për qytetarët", thuhet në letër.

> **OFRIMI I OPSIONEVE**
> Përfaqësuesja e lartë e BE-së, Mogherini; Komisionerja për tregti Malmstrom dhe Komisioneri Hahn në një letër të përbashkët drejtuar Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt ofrojnë opsion për zgjidhjen e problemit të tarifave ndaj Serbisë. BE ofron mes tjerash që emërimi "UNMIK" në CEFTA të zëvendësohet me "Kosova". Por kërkojnë që si shenjë e vullnetit të mirë, para 17 dhjetorit, kur në Bruksel zhvillohet takimi i Këshillit të MSA-së, Kosova përkohësisht të pezullojë zbatimin e vendimit për tarifën ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Opinioni i Ditës

# Ushtria e Kosovës shteron ëndrrat serbiane

Nga Azgan Haklaj

*(vijon nga faqja 1)*

... e Kosovës është dyfish legjitime dhe e domosdoshme për të mbrojtur lirinë dhe popullin e saj.

Ky popull në shekuj është kërcënuar nga shfarosja, dëbimi nga trojet e veta amtare, kolonizimi e asimilimi i dhunshëm nga hordhitë e Azisë dhe falangat e përgjakshme serbo-sllave.

Sot është një moment historik për Kosovën e mbarë Kombin shqiptar.

Ditëlindja e Ushtrisë së Kosovës, ushtrisë më të re në botë, e pagëzuar nga aleati ynë i madh Amerika, nga fuqitë europiane: Gjermania, Franca dhe Anglia, nga gjaku i bijve të saj trima, të cilët si kalorësit e vjetër dardanë e ata të Gjergj Kastriotit u hodhën si shqiponjat në zjarrin e betejave për liri dhe e dhanë jetën për të.

Gjeneralët që i komanduan në shekuj djemtë trima të Kosovës, mbretërit dardanë, Milloshi i Drenicës e Lekë Dukagjini, Sylejman Vokshi, Ali Ibra, Mic Sokoli, Sef Kosharja e deri tek UÇK-ja e lavdishme e emblemat e saj, Jasharajt dhe Haradinajt, i ndanë fishekët e fundit në betejë me bashkëluftëtarët e tyre, sipas kodit të lashtë të nderit, të rrënjosur prej shekujsh në genin e luftëtarëve të lirisë.

Nga sot Kosova, kombi ynë dhe Ballkani do të jenë më të lirë, sepse ekuilibri i forcës është i garantuar tashmë në gadishullin tonë, i cili jo për faj të shqiptarëve u ba shesh betejash, masakrash, jo vetëm në Mesjetë, por edhe në dy luftërat e fundit botërore dhe në vitet '90-të, pas aktit të shpërbërjes së Jugosllavisë Titiste.

Mungesa e shtetit dhe e një ushtrie të armatosur e të stërvitur ka qenë thembra e Akilit për shqiptarët në epokën e nacionalizmit të egër ballkanas të shekujve 19-20.

Një popull i paarmatosur u vu prej 150 vjetësh në grykën e topave, mitralozave dhe tankeve, në majat e bajonetave, duke mos kursyer as fëmijët në bark të nanës. Fqinjët tanë barbarë, të armatosur deri në dhëmbë kanë vrarë e masakruar, shpërngulur me dhunë, burgosur e internuar gati gjysmën e popullsisë autoktone shqiptare të Kosovës, Nishit, Sanxhakut, Shkupit, Manastirit, Çamërisë e Malit të Zi.

Në historinë e Europës nuk ka ndodhur kurrë që ndaj një populli të hartohen projekte shfarosëse, kolonializuese e asimiluese, siç ishin "Megalidhea" greke dhe "Neçertania" serbe. Shpërnguljet me dhunë e masive të shqiptarëve nga trojet e veta etnike kanë filluar qysh në vitet '70-të të shekullit të 19-të, duke kulmuar me dëbimet masive drejt Turqisë në marrëveshjen serbo-sllave-turke të vitit 1938, shpërnguljet e çamëve të vitit 1945, projekti Tito-Rankoviç i vitit 1952, marrëveshja jugosllavo-turko- greke e shkurtit 1953, e quajtur Pakti Ballkanik, i cili u finalizua me shpërnguljet e mbi 400.000 shqiptarëve në vitet 1953-1968. Në vend të tyre u sollën 63.000 kolonë sllavë. Në këto vite janë dëbuar me dhunë mijëra shqiptarë të Malit të Zi nga Hoti, Gruda, Plavë-Gucia, Vuthaj, Ulqini, Tivari, Trieshi, Kraja.



Historia u përsërit si në Luftën e Parë Ballkanike, ku patën përdorur një makineri kolosale lufte dhe plot 270.000 ushtarë serbë që Kosova e lirisë dhe e kuvendeve të mëdha, Kosova e kryengritjes së përgjithshme, që u finalizua me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, të pushtohej nga barbarët sllavë.

Të njëjtën gjë u përpoq të bënte "kasapi i Ballkanit", Sllobodan Milloshevici: të shpërngulte me dhunë krejt shqiptarët nga Kosova.

Sot Kosova ka ushtrinë e saj.

Historia na ka mësuar se një popull që e ka bërë lirinë idealin më të lartë të ekzistencës së tij kur është i armatosur, është i pamposhtur në rrugën e tij historike e në vet' ardhmërinë e tij.

Askush tjetër, përveç barbarëve, çetnikëve e falangave të përgjakshme të etura për gjak e zaptim territoresh të huaja nuk e ka frikë krijimin e Ushtrisë së Kosovës.

Shqiptarët kanë dhanë prova të qarta gjatë historisë së tyre e madje edhe në kulmin e fuqisë ushtarake se nuk janë treguar agresorë ndaj fqinjëve të tyre. E kundërta ka ndodhur ndaj nesh.

Sot në trojet iliro-dardano-arbërore janë vendosur kryeqytetet e Maqedonisë e Malit të Zi. Kjo, jo për faktin se shqiptarët nuk ishin trima e patriotë, por për shkak të forcës së armëve, të intrigave të Fuqive të Mëdha e të barbarizmave të agresorëve gjakatarë. Jepu armën në dorë shqiptarëve e nxirri në mejdan përballë bajlozëve të tokës dhe detit, ata bëhen të gjithë Gjergj Elez Alija. Armatose një vajzë apo grua arbërore e ajo do të kujtojë në betejë Amazomat, Teutën Ilire, Mamica Kastriotin, Norën e Kelmendit e Shote Galicën.

E drejta zakonore shqiptare dhe kodi ynë i nderit e ndalon rreptësisht jo vetëm pushtimin e territoreve të huaja, por edhe vrasjen e burrave të paarmatosur, grave, fëmijëve e pleqve.

Për ta mbrojtur lirinë e atdheun nuk mjafton trimëria dhe dashuria për të, apo fakti se je më i madh, apo më i vogël në numër se agresori. Në radhë të parë duhet të jesh i armatosur deri në dhëmbë dhe i gatshëm për të ndarë fatet e atdheut tënd në fushën e mejdanit.

Shumë historianëve u duket e habitshme, e pabesueshme, por faktet vërtetojnë që mongolët pushtuan Kinën; Aleksandri i Madh Europën, Persinë, Egjiptin, Indinë e Babiloninë me ushtrinë iliro-trake. Aztekët e Hindusit përzunë pushkët e topat e pushtuesve spanjollë. Suedia e vogël mundi Rusinë. Ka mbetur e skalitur në memorien historike qëndresa për mbrojtjen e Trojës, apo Kartagjenës. Beteja e spartanëve të Leonidhës përballë ushtrive të Kserksit. Beteja me hordhitë turke për mbrojtjen e Konstandinopojës, e cila zgjati 53 ditë derisa ra më 29 maj 1453. Aktet heroike të luftëtarëve të Konstadinopojës udhëhiqeshin nga ky flamur që kanë shqiptarët sot.

Sikur Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) të zotëronte mjetet e Aleksandrit të Madh apo të Jul Qezarit do të dëbonte përgjithmonë Turqit nga Europa dhe do të ndryshonte krejt rrjedhën e historisë. Kështu është shprehur ishstudenti i "Sarbonës" së Francës, profesori e patrioti i madh, Abaz Ermenji, në veprën e tij "Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë".

Sot bijtë e Gjergj Kastriotit e kanë ushtrinë e tyre dhe atdheu i thërret nën armë.

Sot ëndrrat serbe janë shteruar përgjithmonë. Ëndrrat e Car Llazarit, Stefan Dushanit, të Çubriolloviçëve, Rankoviçit, Sheshelit e Aleksandër Vuçiçit u shuan përjetësisht.

Atyre që janë skeptikë për aftësitë luftarake e forcën ushtarake të Kosovës, dua t'u kujtoj se shqiptarët e armatosur shndërrohen në gladiatorë në betejë dhe janë të pamposhtur. 600-700 kalorës të Maltës në shekullin e 16-të e mbajtën fortesën e tyre për 13 muaj përballë 40.000 forcave turke dhe i detyruan të zmbrapseshin.

Nëse agresorët e nesërm do të guxojnë ta provojnë forcën e Ushtrisë së Kosovës, fati i tyre nuk do të jetë më i mirë se ai i koalicionit egjiptiano-arab i vitit 1967 kundër Izraelit.

Ushtria e Kosovës kërkon përgatitje të lartë, disiplinë e sakrifica të mëdha, por është mënyra e vetme për të mbrojtur keshtjellën e pamposhtur.

I madhi Xhorxh Uashington kur luftonte kundër ushtrive separatiste të jugut në Amerikë ndërtoi në katër vjet një rrjet prej mijëra kilometrash rrugësh e hekurudhash për zhvendosjen e shpejtë të ushtrisë e mjeteve të saj logjistike, i cili është faktor vendimtar për fitoren.

Ushtria e Kosovës së shpejti do të ketë arsenalin e saj, artilerinë e rëndë, tanke e autoblinda, helikopterë e avionë luftarakë. Rruga e Kombit është arteria kryesore ku do të operojë Ushtria e Kosovës në rast nevoje. Sigurisht, kërkohen edhe rrugë të reja strategjike e aero-portuale.

Shqipëria si shtet nuk guxon të shmanget nga detyrimet e saj.

Qeveritë shqiptare të sotme e të nesërme duhet të vënë në dispozicion të gjitha asetet kombëtare, ushtarake e bazat e veta logjistike për Ushtrinë e Kosovës, që të garantojë një mbrojtje të përbashkët dhe të pathyeshme, e cila do të legjitimonte të drejtën historike hyjnore të shqiptarëve "Një Komb, Një Ushtri".

Kombi shqiptar pas betejash të përgjakshme për liri e pavarësi, është rreshtuar para botës në kahun e drejtë të historisë. Ai është aleat i NATO-s, i SHBA-ve dhe i Europës Perëndimore. Është aty ku e ka vendin e rrënjët e veta historike e kulturore. Aty ku e ka vendosur kryetrimi i historisë sonë "Gjergj Kastrioti-Moisiu Ynë".

Lavdi, bekim e të ardhme të ndritur Kosovës e ushtrisë së saj, krijuar në vitin jubilar të Gjergj Kastriotit (Skënderbeut). Gëzuar Ushtri e Kosovës!

Opinioni i Ditës

# Për një arsim universitar publik cilësor dhe falas

Nga Valbona Nathanaili

*(vijon nga faqja 1)*

... në bulevard, përballë Kryeministrisë dhe të mijëra studentëve të tjerë nga të gjitha universitetet publike të Shqipërisë, për shkak të tarifave të papërballueshme, ndërkohë që nuk justifikohen me cilësinë e mësimeve, diplomës e të infrastrukturës, me nivelin e aftësive të shumë pedagogëve, me mungesën totale të laboratorëve e mundësive për të qenë pjesë e kërkimit shkencor, në rrjedhojë të:

" Një ligji, për të gjitha llojet e institucioneve të arsimit të lartë, por që penalizon universitetet publike.

" Një vendimi, për t'u regjistruar në arsimin e lartë sipas meritës e preferencës, por promovon amulli, kaotizëm dhe i hap luftë çdo lloj politike sociale.

" Një udhëheqje nga një grup njerëzish të interesuar të ruajnë këtë gjendje degradimi dhe që synim të vetëm kanë shpartallimin me sukses, ditë pas dite, të interesave të publikut.

" Zhdukjes nga synimet prioritare të qeverisë, të zhvillimit të arsimit publik.

" Hartimit të politikave të edukimit nga një grup njerëzish, që e kanë edukimin një biznes më shumë dhe interesat e shoqërisë një llogore tjetër që duhet shpartalluar.




Kërkohet:

" Të bëhet një ndryshim rrënjësor e cilësor në arsim, sepse arsimi nuk pret!

" Që ndërmjet shpenzimeve të luksit që propozohen për rrugë e vepra që do i kishin zili edhe vendet më të përparuara të Evropës, dhe shpenzimeve më shumë nga buxheti i shtetit për arsim të lartë publik e cilësor, të zgjidhet alternativa e dytë, sepse të gjithëve duhet t'u jepet mundësia të mësojnë e ndjekin një shkollë të lartë cilësore.

Kërkesat e të rinjve që prej dhjetë ditësh qëndrojnë në protestë, në bulevard, ndërkohë që duhej të ishin në auditorë e laboratorët e kërkimit shkencor, janë kërkesat e të gjithë shoqërisë!

Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë vendi i pabarazive dhe shpërndarjes josimetrike të mundësive. Në këto tri dekada postkomunizëm, biseda për arsimin e lartë është mbizotëruar vetëm nga zërat që e kanë parë këtë sektor si treg, si mundësi për të bërë biznes, për të fituar dhe abuzuar, dhe asnjëherë si interes publik. Sistemi arsimor ka detyruar më shumë të rinj të largohen, ka prodhuar më shumë të papunë, ka nxitur gjithnjë e më shumë pakënaqësi.

Si shoqëri duhet t'u japim mundësi të gjithëve të mësojnë e të ndjekin një shkollë të lartë e të marrin një arsim cilësor sa më bashkëkohor - askush nuk duhet të ndihet i përjashtuar, ose i lënë mënjanë për mungesë fondesh a të ardhurash. Fëmijët e atyre që nuk kanë, duhet të edukohen po aq mirë sa fëmijët e atyre që kanë.

Shërbimi që një edukim cilësor i bën shoqërisë, materializuar në një universitet publik e të arritshëm për të gjithë është i madh. Për këtë arsye, sa më i madh të jetë shërbimi, aq më e vogël duhet të jetë pagesa e konsumatorëve të tij.

Pas plotësimit të menjëhershëm të të gjitha kushteve të vendosura nga studentët, artikuluar qartë dhe pa ekuivok, rruga e mëtejshme duhet të jetë:

1. Rritja e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë publik, në nivelin e mesatares së vendeve evropiane. Një e ardhur që mund të krijohet është krijimi i një takse emergjente për arsimin, për një periudhë 5- vjeçare, nga të gjitha kompanitë e korporatat me një buxhet përtej një vlere të caktuar.

2. Ndryshimi i mënyrës së regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë publik: si hap të parë, duke hequr listimin e universiteteve private nga formulari që plotësojnë maturantët-kandidatët për studentë.

3. Ndryshimi i Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007, Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar me Ligjin Nr. 9832, datë 12.11.2007) sepse:

" Cenon autonominë e universiteteve publike, në shumë pika, veçuar: Neni 14, pika c, "Senati akademik vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit"; Neni 15, pika ë, "Rektorati zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik dhe këshilli i administrimit"; Neni 16 Këshilli i administrimit, pika 1: "Këshilli i administrimit është organ kolegjial vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e institucionit të arsimit të lartë, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij; pika 4: Këshilli i administrimit përbëhet nga: a) anëtarë të personelit akademik, së paku me gradë shkencore, të zgjedhur drejtpërdrejt nga personeli akademik i çdo njësie kryesore të institucionit; b) anëtarë të caktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor; c) një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të institucionit; pika 5: Anëtarët, sipas shkronjës "b" të pikës 4 të këtij neni caktohen dhe shkarkohen nga ministri i Arsimit dhe Shkencës. Numri i anëtarëve të caktuar është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.

4. Krijimi i një Asambleje Kombëtare për Arsimin, me këto detyra e përgjegjësi:

" Funksionon për një periudhë 2-vjeçare, me përbërje jo më shumë se 100 veta nga të gjitha universitetet publike, pedagogë e studentë, si dhe grupe të ndryshme interesi, që do të mblidhet në Kuvendin e Shqipërisë, një herë në muaj.

" Ka detyrë draftimin e një strategjie për përmirësimin e zhvillimin e arsimit të lartë në veçanti dhe arsimin në përgjithësi.

Arsimi nuk pret!

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të jeni shumë optimistë gjatë ditës së sotme. Mund të arrini sukses në një çështje biznesi. Në mbrëmje do të ndiheni krenar për suksesin tuaj gjatë një eventi të rëndësishëm. Tregoni kujdesin e duhur ndaj familjarëve dhe partnerit tuaj.

### DEMI

Disa persona të kësaj shenje do të kenë një bisedë të vështirë me persona të rëndësishëm në punën tuaj. Duhet të tregoheni të kujdesshëm për çdo detaj, pasi kjo mund të ndikojë në të ardhmen e punës suaj.

### BINJAKET

Mund të shënoni sukses në karrierë. Megjithatë, tregohuni objektiv dhe mos e mbivlerësoni veten. Në vend që të bëni këtë, është e rëndësishme të mendoni edhe për çështje të tjera, që nuk kanë lidhje me profesionin.

### GAFORJA

Disa persona të kësaj shenje do të mund të hedhin dritë mbi një çështje shumë të ndërlikuar nga e kaluara. Ka gjasa që të befasoheni nga faktet që do të zbuloni. Megjithatë, përkushtojuni më shumë qetësisë sesa të merreni me çështje nga e kaluara.

### LUANI

Luanët do të punojnë sot me shumë entuziazëm. Nëse e shprehni veten si profesionist, kjo mund t'ju ndikojë pozitivisht në karrierën tuaj. Bëni kujdes, pasi mund të lëndoheni nga një person shumë i afërt me ju.

### VIRGJERESHA

Mund të zhvilloni një bisedë shumë të sinqertë me dikë pranë jush. Edhe nëse zbulon se ky person nuk ka mundësi t'ju ndihmojë, përpiquni ta kuptoni dhe ta mbështesni atë në situata të caktuara. Mos ndërmerrni vendime të nxituara për çështje biznesi sot.

### PESHORJA

Disa personave të kësaj shenje do t'ju duhet të përballen me disa gabime nga e kaluara. Megjithatë, duke menduar pozitivisht, do ta kaloni një situatë të tillë. Në mbrëmje mund t'ju vijë një ftesë për të qenë pjesë e një eventi mes miqsh.

### AKREPI

Do të kaloni një ditë të mirë si nga ana profesionale, ashtu edhe nga ajo personale. Mund t'ju hapen dyer që do t'ju bëjnë të ecni përpara në karrierë. Do të kaloni një mbrëmje shumë të këndshme me partnerin/partneren tuaj dhe mund të merrni një dhuratë të papritur.

### SHIGJETARI

Do të përfshiheni në një bisedë me një mik të vjetër. Gjatë ditës do të përballeni me situata të ndryshme, të cilat do t'ju bëjnë të ndiheni mjaft mirë. Është shumë e rëndësishme të mbani veten nën kontroll dhe të jeni të qartë për vendimet që do të ndërmerrni.

### BRICJAPI

Ndihma që do t'i jepni një miku do ta nxjerrë nga një vështirësi, e cila mund t'i rrezikojë edhe vendin e punës. Do t'i kushtoni kohën e duhur familjes suaj gjatë ditës së sotme. Megjithatë, duhet t'i përkushtoheni më shumë vetes, pasi e keni të nevojshme si fizikisht, ashtu edhe psikologjikisht.

### UJORI

Shumë ujorë do të përfshihen sot në punë kolektive. Do të keni një rol të rëndësishëm në organizimin e festës që puna organizon për Krishtlindje. Rrethanat do t'ju bëjnë që t'i bashkoheni një grupi personash me të njëjtin qëllim. Në darkë do të përjetoni një romancë të re.

### PESHQIT

Do të refuzoni të ndryshoni mënyrën tuaj të të vepruarit. Kushtojini vëmendje çështjes ekonomike. Duhet ta rimendoni listën e shpenzimeve. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

## LIVERPULI FITON 3-1

Futet në minutën e 70-të në lojë, realizon dygolësh për 10 minuta në fushë dhe bën të çmendet "Anfield Road". Xherdan Shaqiri, fenomenal në sfidën ndaj Mançester Junajtid. Golat e tij u dhanë fitoren 3-1 të kuqve në shtëpi, duke rikthyer skuadrën e Jurgen Klop në vendin e parë në Premier League me 45 pikë, 1 më shumë se Mançester Siti.



### "Mad-Shaq"! Dy golat e Xherdanit shembin Mançesterin

Por çfarë ndodhi në këtë sfidë, një nga më të pabesueshmet në karrierën e futbollistit të lindur në Gjilan? Liverpuli kaloi në epërsi që në minutën e 25-të me Sadio Mane, por Xhesi Lingard përfitoi nga një pasiguri e portierit brazilian Alison, duke kthyer baraspeshën në rezultat në minutën e 33-të. Vendësit nuk po arrinin ta çanin mbrojtjen e "Djajve të Kuq", por zgjidhjen Klop e kishte në stol, pikërisht Xherdan Shaqirin, që sapo zbret në fushë, i jep një tjetër marsh lojës sulmuese të skuadrës së tij. Në minutën e 73-të goditi saktë brenda zonës në një pozicion të volitshëm, me topin që goditi shtyllë e përfundoi në rrjetë, ndërsa në minutën e 80-të realizoi të dytin me një tjetër goditje të kalibruar, thuajse nga vija e 16 metrave. Kaq mjaftoi që Liverpuli të merrte një fitore shumë të rëndësishme me protagonist absolut Xherdan Shaqirin, "asin nën mëngë" të Jurgen Klop, i hedhur në fushë në momentin e duhur për t'i dhënë një mësim të mirë Zhoze Murinjos.

Ndeshje e çmendur në Korçë. Gjirokastritët triumfojnë 3-2, kampionët akuzojnë gjyqtarin

# Teuta është për titull, Luftëtari thyen Skënderbeun

## "Djemtë e Detit" shpartallojnë Kastriotin 4-0



Jeton Selimi

Gola, spektakël dhe Luftëtari triumfues në Korçë. Skënderbeu-Luftëtari ishte pa dyshim një nga sfidat më të bukura të këtij sezoni, që nxori ndoshta edhe me shumë fat fituese skuadrën gjirokastrite, me rezultatin përfundimtar 2-3. Në përballje që doli jashtë skemave taktike, me sulme e kundërsulme të shpejta nga të dyja skuadrat, ku portierët Teqja dhe Ruçi, sidomos "gardiani" bluzi u bënë protagonistë me disa ndërhyrje vendimtare. 25 minutat e para ishin vërtet të çmendura. E hapi serinë e golave Bregu, në minutën e 10-të, i ndihmuar edhe nga devijimi i mbrojtjes, por vetëm një minutë më pas barazoi Demo, në zhvillimet e një goditjeje të lirë për miqtë. Luftëtari shtangu tifozët korçarë në minutën e 18-të, moment kur Radas në tentativë për të larguar rrezikun devijoi në portën e Teqjes. Gjithsesi, në të 25'-tën Bregu ekzekutoi mjeshtërisht një goditje të lirë, duke e lënë të palëvizur Ruçin. Skënderbeu iu afrua shumë herë golit në pjesën e dytë, por pas një rasti të shpëtuar në limit nga portieri dhe mbrojtja korçare, Luftëtari fiton një 11-metërsh, që u



shndërrua në gol nga Shkurtaj. Kontestuan me forcë futbollistët vendës, por arbitri nuk kishte asnjë dyshim për penalltinë e dhënë. Të kota tentativat e Skënderbeut në minutat e fundit, ndërsa Luftëtari iu gëzua një fitoreje të madhe, që e largon nga zona e ftohtë. Kjo disfatë i kushton shumë Skënderbeut, që sheh ta parakalojnë në renditje si Kukësi dhe Teuta, ndërsa Partizani kryesues shkon +6 pikë. Teuta është shumë e fortë për Kastriotin. Vazhdon momenti i artë për "djemtë e detit".

**SUPERLIGA**

*TË PREMTEN*

| | |
|---|---|
| Partizani - Kukësi | 0-0 |

*TË SHTUNËN*

| | |
|---|---|
| Laçi - Tirana | 2-1 |
| Flamurtari - Kamza | 1-0 |

*TË DIELËN*

| | |
|---|---|
| Kastrioti - Teuta | 0-4 |
| Skënderbeu - Luftëtari | 2-3 |

*RENDITJA*

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Partizani | 17 | 36 |
| Teuta | 17 | 32 |
| Kukësi 17 | 31 | |
| Skënderbeu | 17 | 30 |
| Laçi | 17 | 29 |
| Flamurtari | 17 | 28 |
| Luftëtari17 | 16 | |
| Tirana 17 | 14 | |
| Kamza | 17 | 12 |
| Kastrioti | 17 | 10 |

Skuadra e Bledi Shkëmbit triumfoi lehtësisht me shifrat e thella 0-4 në stadiumin "Redi Maloku" të Fushë-Krujës ndaj Kastriotit vendës, duke regjistruar fitoren e 7-të në 10 takimet e fundit, në të cilat Teuta nuk njeh humbje. Një fitore me peshë kjo e ngjiti përkohësisht skuadrën durrsake në vendin e 2-të, vetëm 4 pikë larg Partizanit kryesues. Ai që i hapi rrugën fitores së "djemve të detit" ishte talenti Sherif Kallaku, ndërkohë që në pjesën e dytë fillimisht shënoi Gerhard Progni me kokë, i cili qetësoi trajnerin Shkëmbi në stol, ndërsa në fund kishte vend edhe për finalizimin e Amadu Latif dhe supergolin e talentit shkodran Uendi Vecaj. 24 pikë të grumbulluara në 10 javët e fundit janë sinjalet se kjo Teutë është vërtetë frikshme dhe mund të jetë një kandidate e fortë për titullin kampion. Ndërkohë te Kastrioti tashmë nuk jep më efekt as kura 'Nica', me skuadrën krutane, që pësoi humbjen e dytë radhazi me shifrat e thella 4-0 këtë herë në shtëpi, duke treguar dhe njëherë se Kastrioti është skuadra më e kuotuar për t'u rrëzuar një kategori më poshtë.

## SULMUESI I LUFTËTARIT



### Shkurtaj: Fitore morali, pres oferta!

Sulmuesi i Luftëtarit, Vasil Shkurtaj pranoi për "Supersport" se e ardhmja e tij mund të jetë larg skuadrës gjirokastrite. Gjithashtu, Shkurtaj pranoi se ka marrë oferta si nga skuadra të Superiores, ashtu edhe nga ekipe jashtë. Në fjalën e tij, Shkurtaj tha: "Fitorja që morëm sot (dje) është më shumë për moralin tonë. Tani të shohim ndeshjen kundër Partizanit, që do jetë një ndeshje shumë e vështirë. Tani po mendojmë vetëm të largohemi nga kjo pozitë e vështirë që jemi në tabelë, më pas do të shohim ecurinë edhe në Kupë, edhe në kampionat. Në këto momente jam lojtar i Luftëtarit, nuk e di çfarë do të ndodhë në janar. Të them të drejtën, po mendoj vetëm për Luftëtarin. Kush do që të më blejë, e di se ku mund të më gjejë. Më kanë ardhur disa oferta nga Shqipëria, por edhe nga jashtë, por nuk mund të flas me emra konkretë", - u shpreh Shkurtaj.

## MOVIOLA

### Penalltia e drejtë, Sambou ndëshkohet për faullin, jo prekjen e topit

Aksioni i minutës së 84-t të pjesës së dytë të ndeshjes mes Skënderbeut dhe Luftëtarit do të kujtohet për një kohë të gjatë, pasi ishte ai që përcaktoi fatin e ndeshjes mes dy skuadrave. Një gjuajtje drejt portës devijohet me kokë nga Kaba Sambou dhe gjyqtari Hermal Llapra bën shenjë nga pika e bardhë. Në stadium nisin protestat dhe me të drejtë, pasi lojtarët i bëjnë me shenjë kryesorit se mbrojtësi ka prekur topin me kokë. Protesta pa fund, por Llapra nuk u kthen përgjigje, vetëm bën shenjë nga pika e bardhë, duke tensionuar edhe më shumë situatën. Pas ndeshjes, pasi situata ishte tensionuar për minutat e mbetura, në tribuna dhe në fushë, sipas "SuperSport", ai ka shpjeguar se kishte dhënë penalltinë, meqë kishte cilësuar faull rrëshqitjen e Sambou, që kishte devijuar topin me kokë, por me këmbë kishte ndërhyrë në mënyrë të parregullt ndaj kundërshtarit.

## TRAJNERI I SKËNDERBEUT

### Shehi: Nuk jemi më Skënderbeu i 8 viteve më parë, por gjyqtari...

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi foli për "Supersport" pas ndeshjes, ku u shpreh shumë i zhgënjyer nga rezultati kundër Luftëtarit. Në fjalën e tij, Shehi tha: "Pasaktësia në fund fare, në metrat e fundit, po na mungon. Shkojmë mirë deri atje dhe gabojmë në pasimin e fundit. Sidomos në pjesën e dytë nuk gjuajtëm në portë ashtu siç duhet. Kemi pasur probleme, Dita me kartonë, Hoxha i dëmtuar, Abazi kishte probleme, Muzaka me zor e shtyu. U përshtatëm me ata që kemi dhe nuk kishim



alternativa të tjera. Kemi kërkuar që kur të shkojmë në fundore e të dalim aq pastër sa dilnim, të kishim mbështetjen e mesfushorëve. Ajo e Guindou ishte penallti dhe gjyqtari e kishte të pastër pamjen. Unë kam thënë që nuk merrem me gjyqtarë, por ky nuk është gjyqtar, ky është autoshkollë. Më vjen keq që në Korçë vijnë gjyqtarë pa eksperiencë, ka ndodhur edhe herë të tjera, me Kamzën e në raste të tjera. Skuadra lodhet gjithë javën dhe vjen një gjyqtar e jep një penallti, që nuk e di se çfarë penalltie është. Në momentin që Devi doli i gjakosur të marrte ndihmën, ai i jep kartonë e mungon në ndeshjen tjetër. 'Se simulove' tha, 40 metra larg portës. Nuk jemi Skënderbeu i 8 viteve të para, ndryshimet kanë qenë të shumta. Ndoshta pak lojtarë që nuk janë mësuar të mbajnë presion e ndjejnë dhe kërkojnë të japin me shumë. Kjo i dëmton, por do të thosha që nuk janë objektiva reale, por të shohim se si do të rrjedhin ngjarjet në vazhdim".


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al